

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5796
E shtunë, 8 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Vizita në
Berlin i ka dhënë shtytje
të re liberalizimit
të vizave | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**GJENOCIDI
DHE TERMI
'SHFAROSJE'**

F. 11

Bardhyl MAHMUTI



**FJALIM I
MADH PËR
KOSOVËN NË
BEOGRAD** F. 12

Ismet SYLEJMANI



AKTUALE

**BE-ja ANULON PROJEKTIN
12 MILIONËSH NË KOSOVË**

F. 5

**LV-ja: TEKSTET SHKOLLORE
PO BËHEN PËR KLIENTELË,
JO PËR NXËNËS** F. 7

**BAHTIRI BËN THIRRJE QË
TË PENGOHET KOLONIZIMI I
MËTEJSHËM I VERIUT** F. 10

EKONOMI



**MPMS-ja DHE UNDP-ja
HAPIN 'PANAIRIN E
VETËPUNËSIMIT 2019'** F. 9

**ODA AMERIKANE PREZANTON
POTENCIALET PËR INVESTIME
NË KOSOVË EDHE NË BRITANI**

F. 9

'Epoka e re' për herë të dytë kampione e Media Ligës

Gazeta "Epoka e re" e ka shkruar historinë në Media Ligë pasi është bërë ekipi i parë që e fiton dy herë trofeun e më të mirit. "Epoka..." që nga fillimi e deri në fund të këtij edicioni të kësaj lige ishte ekip dominues dhe me plot meritë është shpallur kampione. Nga 30 ndeshjet e zhvilluara ky ekip arriti t'i regjistrojë 23 fitore, 4 barazime dhe 3 humbje. "Infokusi" dhe "Media Works"-i janë ekipet që kanë përfunduar kampionatin në pozitën dy dhe tre. Lojtari më i mirë i turneut është shpallur Erzen Zyberaj i "Epokës së re", kurse epiteti i portierit më të mirë i ka takuar Arsim Popajt të "Lajmi.net"



FLET PËR "EPOKËN E RE", HAXHI SHALA | FAQE 4-5

Opozita ka mbetur pa tema, prandaj po përmend mocionin

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Haxhi Shala, ka bërë me dije se subjektet opozitare kanë mbetur pa tema, prandaj po merren me rrëzimin e qeverisë. Në

këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëpërmjet mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë opozita po përpjet ta tërheqë vëmendjen e opinionit. Shala e ka vlerësuar joserioze këtë

iniciativë, duke thënë se deri më tani nuk është treguar pse duan ta rrëzojnë këtë qeveri. Sipas deputetit të Nismës Socialdemokrate, nuk pritet të ketë zgjedhje të parakohshme këtë vit

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Bundestagu, rol kyç për garantimin e perspektivës evropiane të Shqipërisë



TIRANË, 7 QERSHOR - Gjatë qëndrimit në Berlin, ku mori pjesë në takim të 24 ndërkombëtar të Berlinit, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, u takua edhe me përfaqësues të grupeve parlamentare kryesore në Bundestag, për të diskutuar lidhur me perspektivën evropiane

të vendit, veçanërisht për çeljen e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian sa më parë.

Në takimin që pati me nënkryetarin e Grupit Parlamentar CDU/CSU, Johann Wadephul dhe raportuesin për Shqipërinë për

CDU/CSU në Komisionin e Jashtëm, Christian Schmidt, ku u diskutua mbi perspektivën e çeljes së negociatave të anëtarësimit, presidenti Meta vlerësoi angazhimin e tyre si dhe gatishmërinë për të ndihmuar në kapërcimin e krizës dhe për rivendosjen urgjente të dialogut politik.

Presidenti Meta u takua edhe me zëdhënësin për politikën e jashtme të Grupit Parlamentar SPD në Komisionin e Politikës së Jashtme, Nils Schmid, të cilin e falënderoi për mbështetjen për çeljen e negociatave të anëtarësimit dhe në tërësi për procesin e integritimit evropian.

Thaçi: Duam marrëveshje me Serbinë që do të sillte njohje reciproke

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Kosova është e gatshme për një marrëveshje me Serbinë, e cila do të sillte njohje reciproke, pa kufij me vija etnike dhe që do ta mundësonte anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe që do ta sillte njohjen e pesë vendeve të BE-së, përfshirë Sllovakinë



PRISHTINË, 7 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë fjalës së tij në Forumin "GloboSec", i cili është duke u mbajtur në Bratislavë, ka akuzuar homologun e tij serb, Aleksandër Vuçiq, për pengimin e vazhdimin të dialogut me Kosovën. Thaçi ka thënë se Kosova është e gatshme për një marrëveshje me Serbinë, e cila do të sillte njohje reciproke. "Duam marrëveshje me Serbinë që do të sillte njohje reciproke, pa kufij me vija etnike. Një marrëveshje e cila do të sillte anëtarësim të Kosovës në OKB dhe që do ta sillte njohjen e pesë vendeve të BE-së, përfshirë Sllovakinë", është shprehur Thaçi.

Presidenti Thaçi ka thënë se ka gjasa që marrëveshja arrihet këtë vit, por vetëm nëse Serbia tërhiqet nga pengesat që i bën dialogut. "Nuk mund të arrihet marrëveshje me gjithë këtë qasje penguese të Serbisë, në përpjekjet e saj penguese për anëtarësim e Kosovës në UNESCO e

Interpol. Por, unë besoj se në javët e ardhshme do të krijohet një klimë për vazhdim të dialogut dhe samiti i Parisit do të jetë një mundësi shumë e mirë për të bërë hapa konkretë për vazhdim të dialogut dhe arritjen e marrëveshjes", është shprehur Thaçi. "Sa i përket tarifave, edhe një herë e di që Vuçiqit nuk i bëhet vonë, e di që i ka humbur disa milionë euro por politikisht ai është i lumtur ashtu siç e ka theksuar. Shpresoj që do të kemi përafrime në ditët dhe javët e ardhshme dhe se bisedimet do të rifillojnë, ndryshe vënia e kushteve është vetëm justifikim për të mos vazhduar bisedimet", tha presidenti Thaçi.

Por, presidenti serb, Aleksandër Vuçiq tha se i takon Serbisë që të luftojë kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol dhe UNESCO dhe sipas tij, nuk ka qenë sjellje agresive. "Ata vendosën tarifa kundër Serbisë, 100 për qind dhe ende më kujtohet që Hashim Thaçi ka

qenë kundër kësaj në natën e parë, të dytë dhe në vazhdim, duke më thënë që do t'i largojmë tarifën shumë shpejt dhe tash u bënë shtatë muaj dhe ne kemi humbur 300 milionë euro, kemi humbur tregun dhe kjo është kundër marrëveshjes së CEFTA-s, të cilën Kosova e ka nënshkruar së bashku me Beogradin dhe me të tjerët në Ballkanin Perëndimor në vitin 2006", tha Vuçiqi. "Për Thaçin e gjithë Kosova u përket shqiptarëve të Kosovës apo kosovarëve apo kjo është një shtet i

pavarur. Por, sipas Kushtetutës së Serbisë e gjithë Kosova i përket Serbisë, edhe bota është e ndarë, absolutisht e ndarë", tha Vuçiq, duke shtuar se gjysma e botës e njeh, por gjysma tjetër nuk e njeh Kosovën e pavarur. Ai tha se angazhohet për një zgjidhje kompromisi, por jo çfarëdo zgjidhjeje që ofron Prishtina.

Presidentët Thaçi e Vuçiq pritet që t'i kryesojnë delegacionet e Kosovës dhe Serbisë në kuadër të një takimi që është thirrur për të shtyrë përpara dialogun

ndërmjet dy vendeve më 1 korrik në Paris, nikoqiri i të cilit do të jenë presidenti francez, Emmanuel Macron dhe kancelaria gjermane, Angela Merkel. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian në Bruksel, ka nisur më 2011. Aktualisht ky proces është bllokuar pasi, presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ka përmendur taksën prej 100 që Qeveria e Kosovës ka vendosur në importet e Serbisë si arsyetim për mosvazhdim të dialogut.

Basha: Asnjë dallim mes krimit e PS-së

TIRANË, 7 QERSHOR - Kreu i opozitës, Lulzim Basha, hodhi akuza të rënda në drejtim të kryeministrit Edi Rama që, sipas tij, e ka ngritur pushtetin mbi drogën dhe krimin ndaj do të përdorë çdo qindarkë për t'i blerë votat me paratë e krimit.

Lulzim Basha bëri të premtën një pasqyrë të qeverisjes së kryeministrit Edi Rama. Basha tha se është në luftë me krimin që prej 6

vjetësh dhe në këtë betejë nuk e përfshiu LSI-në.

Lideri i PD-së, akuzoi Ramën se solli krimin në qeveri, parlament dhe administratë.

"Beteja ime dhe e PD-së këto 6 vjet ka qenë një betejë e vazhdueshme kundër drogës dhe krimit. Këtë betejë e kemi zhvilluar vetëm unë dhe PD-ja dhe shpesh jemi sulmuar dhe anatemuar. Për shkak të propagandës

së shthurur kemi bërë sakrificë të mëdha. Nuk kemi pasur asnjë zgjedhje tjetër. Kriminelët, drogën, krimin në politikë, nuk i solla unë, por i solla personalisht Edi Rama. Lidhjet e Ramës me krimin kanë filluar prej kohësh, që kur ishte kryebashkiak. Rama ka ndarë para dhe pushtet përmes lejeve të ndërtimit dhe krijoi një elitë kriminale në Tiranë. Me paratë e krimit, Rama

bleu Partinë Socialiste. Ai rekrutoi që në opozitë figura të krimit, dhe krijoi një aleancë të rrezikshme PS-krim dhe erdhi në pushtet më 2013. Bashkë me aleancën e krimit erdhën edhe kriminelët që u futën edhe në parlament. Rama e shkriu krimin me politikën, siç e ka parë dhe dëgjuar e gjithë bota perëndimore. Bandat janë shtabe elektorale të PS-së", deklaroi Basha.



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka mbajtur konferencë për medie pas kthimit nga vizita njëditore në Berlin

Haradinaj: Vizita në Berlin i ka dhënë shtytje të re liberalizimit të vizave

Vizita në Berlin i ka dhënë shtytje të re procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Kështu ka deklaruar kryeministri Ramush Haradinaj të premten në një konferencë me gazetarë pas kthimit nga vizita njëditore në Gjermani. Ai ka bërë me dije se në Berlin është diskutuar edhe për procesin e dialogut dhe për taksën ndaj Serbisë mirëpo, sipas Haradinajt, kjo masë mund të pezullohet vetëm në rast të arritjes së marrëveshjes për njohje reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë në kufijtë ekzistues



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë të premten se tashmë Kosova dhe Gjermania kanë nivel të ri të marrëdhënieve bilaterale. Ai ka vlerësuar se vizita e tij në Berlin i ka dhënë shtytje të re procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. "Ka qenë një vizitë njëditore në Berlin dhe një takim pune me kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel. Me këtë vizitë, me këtë komunikim dhe me këtë nivel të ri të marrëdhënieve i kemi dhënë shtytje përpara procesit të liberalizimit të vizave. Vendimi i Gjermanisë pro liberalizimit të vizave besoj se do të jetë inkurajues edhe për vendet e tjera për të hyrë në agjendë kjo çështje në Këshillin e Ministrave të BE-së. Kosova është në një nivel tjetër të marrëdhënieve bilaterale me Gjermaninë, të atyre me Bashkimin Evropian, pra ka avancim të proceseve tona, ashtu sikurse ka avancim në atë që na intereson shumë, çështjen e liberalizimit të vizave", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë për medie.

Kryeministri i vendit ka vlerësuar se në takimet e Berlinit është konfirmuar serioziteti i Kosovës në aspektin e brendshëm dhe në rrafshin ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe procesin e dialogut me Serbinë. "Po në këtë vizitë dhe këto takime është konfirmuar

serioziteti i Kosovës në punët e shtëpisë në qeverisjen e brendshme dhe në agjendën integruuese. Gjithashtu, është vërtetuar edhe serioziteti i Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se në këto takime nuk është diskutuar për çështjen e korrigjimit të kufijve.

Në këtë kontekst, ai ka thënë se Samiti i Berlinit ka mbyllur çështjen e formulave të ndërrimit të territoreve dhe kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Samiti i Berlinit besoj se e ka mbyllur çështjen e formulave për ndërrimin e territoreve, kufijve etj. Kësaj here, nuk ka vazhduar diskutimi rreth një teme të tillë për shkak se nuk ekziston më", ka theksuar ai.

Kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se është në interes të dy vendeve vazhdimi i dialogut dhe arritja e marrëveshjes për njohjen reciproke. "Mendoj se është në interes vazhdimi i dialogut dhe gjetja e një zgjidhjeje për arritjen e një marrëveshjeje për njohjen reciproke Kosovë - Serbi në kufijtë ekzistues", ka thënë ai. Haradinaj ka treguar se në Berlin është diskutuar edhe për taksën ndaj Serbisë mirëpo, sipas tij, kjo masë mund të pezullohet vetëm në rast të ndonjë marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë në kufijtë ekzistues që parasheh njohjen e shtetësisë së Kosovës nga ana e Serbisë.

Haradinaj ka shtuar se taksa nuk është pengesë e dialogut por,

sipas tij, Serbia nuk ka gatishmërinë të kthehet në këtë proces. "Duhet të kemi një kornizë të qartë dhe të dihet se me çka do të shkojmë në dialog. Taksa nuk është pengesa për dialog, por është një mosgatishmëri e Serbisë për t'iu kthyer dialogut. Vuçiqi ka vizituar edhe kryeqytete të tjera dhe e ka harruar këtë adresë. Kosova po e zënë vendin e vet në Gjermani, jo atë të Serbisë", është shprehur kryeministri. Sa i përket koordinimit në mes të liderëve shtetërorë pak para zhvillimit të një takimi në Paris,

mes palës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, Haradinaj ka thënë të mos ketë qenë në dijeni për pjesëmarrjen e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në Forumin e Bratislavës. Megjithatë, sipas tij, është me rëndësi që të gjithë liderët të kenë qëndrime të njëjta në mënyrë që mos të shkaktohen dilema te palët e tjera. "Nuk e kemi ditur se do të ketë prani të Kosovës në Bratislavë, mirëpo është mirë që Kosova paraqitet. Nuk kemi arritur të bëjmë konsulta, mirëpo është me rëndësi që të gjithë të kemi qëndrime të

njëjta, të mos shkaktojmë dilema te palët e tjera. Kosova po e formëson qëndrimin e vet për një marrëveshje për njohje reciproke në kufijtë ekzistues", ka deklaruar Haradinaj.

Gjithashtu, ai ka thënë se Kosova është treguar palë serioze edhe në përgatitjet për Samitin e Parisit. "Sa i përket Samitit të Parisit, është një punë shumë-palëshe, por mund t'ju siguroj se askush nuk mund ta drejtojë gishtin kah Kosova sepse Kosova është treguar palë serioze në përgatitjet e këtij samiti", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Prokuroria ngre 36 aktakuza për 24 orë

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Prokurori i Shtetit ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit nga prokuroritë themelore janë ngritur 36 aktakuza kundër 39 personave për vepra të ndryshme penale. Sipas njoftimit të këtij institucioni, me urdhër të Prokurorit të Shtetit janë ndaluar 13 persona,

është realizuar bastisje në dy shtëpi, në fshatin Mushtisht, Komuna e Suharekës, nën dyshimin për armëmbajtje pa leje.

Gjatë kontrollit nuk janë gjetur armë, me përjashtim të një fisheku të kalibrit 7.62 mm, i cili është sekuestruar nga policia. Po ashtu, gjatë 24 orëve të

fundit janë realizuar katër sekuestrime të përkohshme për vepra të ndryshme penale. "Prokurori i Shtetit ka bërë nëntë 9 kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit kundër personave të ndryshëm për vepra të ndryshme penale", është thënë në njoftimin e Prokurorit të Shtetit.



Flet për "Epokën e re", Haxhi Shala

Opozita ka mbetur pa tema, p



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Haxhi Shala, ka bërë me dije se subjektet opozitare kanë mbetur pa tema, prandaj po merren me rrëzimin e qeverisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëpërmjet mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë opozita po përpiqet ta tërheqë vëmendjen e opinionit. Shala e ka vlerësuar joserioze këtë iniciativë, duke thënë se deri më tani nuk është treguar pse duan ta rrëzojnë këtë qeveri. Sipas deputetit të Nismës Socialdemokrate, nuk pritet të ketë zgjedhje të parakohshme këtë vit

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Deputeti i Nismës Socialdemokrate, Haxhi Shala, nuk e shesh serioze iniciativën e opozitës për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë aktuale. Ai ka thënë se tani opozita ka mbetur pa tema dhe po përpiqet që nëpërmjet mocionit ta tërheqë vëmendjen e opinionit publik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", Shala ka treguar se përmes këtij mocioni subjektet opozitare po përpiqen të tregojnë se kanë bërë diçka në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. "Qeveria aktuale është duke i realizuar disa kauza të mëdha dhe po shihet se tani opozita ka mbetur pa tema. Tani për të krijuar tema për opinion, opozita ka ndërmarrë këtë iniciativë. Besoj se kjo është arsyeja pse pikërisht tani opozita ka menduar për mocionin e mosbes-

imit ndaj qeverisë. Pra, opozita dëshiron të tregojë se ka bërë diçka në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Deri më tani opozita është vetëm në kundërshtim të temave dhe nuk është e gatshme të ballafaqohet me temat me të cilat ballafaqohet vendi", ka thënë Shala.

Ai ka treguar se deri më tani ende nuk ka parë diçka konkrete nga opozita për këtë çështje. Sipas Shalës, opozita duhet të tregojë se

pse po dëshiron rrëzimin e qeverisë. "Derisa nuk kam parë asgjë të shkruar nga opozita, unë nuk po shoh këtë si ndonjë iniciativë serioze nga ana e opozitës për rrëzimin e qeverisë. Në momentin që shoh diçka konkrete, ndonjë shkresë që iu ka drejtuar grupit tonë parlamentar, ndoshta mund të them diçka më konkrete. Mendoj se opozita duhet të japë sqarime më shumë pse është koha për ta rrëzuar qeverinë", është shprehur Shala.

Deputeti i Nismës beson se qeveria po funksionon si duhet dhe se nuk ka arsye për mocion mosbesimi. "Besoj se deri më tani është duke funksionuar si duhet koalicioni qeverisës. Ajo që duhet bërë është se si spektër politik duhet të jemi të bashkuar për çështje kombëtare. Do të duhej që për temat kombëtare, si për dialogun, opozita të na bashkohej. Për këto tema edhe ajo ka përgjegjësi ndaj elektoratit të vet. Sa iu përket punëve të përditshme, besoj se qeveria aktuale është duke funksionuar jashtëzakonisht mirë", është shprehur ai. Sipas Shalës, nuk

pritet të ketë zgjedhje të reja këtë vit. "Siç po shihet, qeveria është duke funksionuar. Kurdo që qeveria nuk është duke e bërë punën e duhur, atëherë pse mos t'i ndërpritet mandati. Se sa do të qeverisë kjo qeveri nuk mund ta di. Nuk besoj se vendi mund të shkojë së shpejti në zgjedhje të reja. Besoj se gjatë vitit 2019 nuk do të ketë zgjedhje", ka thënë Shala.

"Epoka e re": Z. Shala, subjektet opozitare tashmë i kanë mbledhur nënshkrimet e deputetëve të tyre për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. Si e keni parë këtë iniciativë?

Shala: Opozita ka të drejtë ta ngritë mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë nëse arrin t'i mbledhë votat e nevojshme. Pra, është e drejtë e saj legjitime, por ne ende nuk kemi parë asgjë të shkruar rreth kësaj iniciative pse dëshiron ta rrëzojë këtë qeveri. Ajo që kemi parë deri më tani janë vetëm lajmet nëpër media, se opozita është duke u koordinuar dhe duke i mbledhur nënshkrimet për

Grandaj po përmend mocionin



rrëzimin e qeverisë. Deri më tani te Nisma askush nuk ka ardhur të kërkojë ndonjë nënshkrim. Aq sa di unë, askush nuk na ka kontaktuar për këtë çështje ani pse, siç dihet, asaj i nevojiten edhe votat e pozitës për ta rrëzuar këtë qeveri.

"Epoka e re": Sa serioze e shihni këtë iniciativë të opozitës? A mund ta rrezikojë kjo qeverinë?

Shala: Derisa nuk kam parë asgjë të shkruar nga opozita, unë nuk po shoh këtë si ndonjë iniciativë serioze nga ana e opozitës për rrëzimin e qeverisë. Në momentin që shoh diçka konkrete, ndonjë shkresë që iu ka drejtuar grupit tonë parlamentar, ndoshta mund të them diçka më konkrete. Mendoj se opozita duhet të japë sqarime më shumë pse është koha për ta rrëzuar qeverinë.

"Epoka e re": Përveç liderëve opozitarë për këtë çështje janë takuar edhe shefat e grupeve parlamentare të opozitës për ta harmonizuar tekstin e mocionit. Pse mendoni se pikërisht tash këtë po e bën opozita?

Shala: Intensiteti i qeverisë në dialogun me Serbinë është duke u rritur. Qeveria aktuale është duke i realizuar disa kauza të mëdha dhe po shihet se tani opozita ka mbetur pa tema. Për të krijuar tema për opinion, opozita ka ndërmarrë këtë iniciativë. Besoj se kjo është arsyeja pse pikërisht tani opozita ka menduar për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. Pra, opozita dëshiron të tregojë se ka bërë diçka në këtë gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

Deri më tani opozita është vetëm në kundërshtim të temave dhe nuk është e gatshme të ballafaqohet me temat me të cilat ballafaqohet vendi.

"Epoka e re": Synimi i opozitës është që për rrëzim të qeverisë t'i marrë edhe disa vota të deputetëve nga koalicioni qeverisës. Mund të pritët që ndokush prej deputetëve të pozitës t'i bëjë argat opozitës në këtë rast?

Shala: Nuk e di se çka mund të bëjnë të tjerët. Nëse dikush ka ndonjë arsye për rrëzimin e qeverisë, ndoshta mund ta japë votën. Përderisa ende nuk kemi parë diçka konkrete nuk di çka të them për këtë çështje.

"Epoka e re": Mirëpo deputeti i koalicionit qeverisës, Milaim Zeka, ka thënë se do t'ia japë votën opozitës për ta rrëzuar qeverinë. E ka seriozisht z. Zeka?

Shala: Nuk e di se kur e ka seriozisht e kur nuk e ka seriozisht Milaimi. Por, po e përsëris, të shohim se çka po prezanton opozita në Kuvend.

"Epoka e re": Ju po thonë se koalicioni qeverisës po i kryen disa punë të mëdha për vendin, por opozita është mjaft kritike ndaj punës së kësaj qeverie. Sipas jush, po funksionon si duhet koalicioni qeverisës?

Shala: Besoj se deri më tani është duke funksionuar si duhet koalicioni qeverisës. Ajo që duhet bërë është se si spektër politik duhet të jemi të bashkuar për çështje kombëtare. Do të duhej që për temat kombëtare, si për dialo-

gun, opozita të na bashkohej. Për këto tema edhe ajo ka përgjegjësi ndaj elektoratit të vet. Sa iu përket punëve të përditshme, besoj se qeveria aktuale është duke funksionuar jashtëzakonisht mirë.

"Epoka e re": Por, edhe vetë koalicioni qeverisës nuk ka qenë shumë i bashkuar për çështjen e taksës. A i kanë tejkaluar këto dallime partnerët e koalicionit qeverisës?

Shala: Besoj se koalicioni qeverisës ka qenë unik rreth taksës ndaj mallrave serbe, sepse taksa në qeveri është votuar nga të gjithë partnerët e koalicionit qeverisës. Dhe asnjëherë taksa më nuk është kthyer në kabinetin qeveritar për t'u hequr. Përderisa nuk kemi një veprim të tillë, mendoj se i gjithë koalicioni qeverisës është pro taksës. Ndërsa deklarimet e ndryshme publike për këtë çështje mund të jenë mendime të liderëve të caktuar politikë. Mirëpo si qeveri mendoj se jemi unikë në raport me taksën ndaj mallrave serbe.

"Epoka e re": Prej fillimit të këtij koalicioni qeverisës është përmendur mundësia e zgjedhjeve të reja. Mund të kemi zgjedhje të reja në këtë vit?

Shala: Siç po shihet, qeveria është duke funksionuar. Kurdo që qeveria nuk është duke e bërë punën e duhur, atëherë pse mos t'i ndërpritet mandati. Se sa do të qeverisë kjo qeveri nuk mund ta di. Nuk besoj se vendi mund të shkojë së shpejti në zgjedhje të reja. Besoj se gjatë vitit 2019 nuk do të ketë zgjedhje.

BE-ja anulon projektin 12 milionësh në Kosovë

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë ka njoftuar se i është dashur të anulohet një projekt prej 12 milionë eurosh për ndërtimin e deponisë së mbeturinave të rrezikshme në Kosovë. Ky projekt përfshinte ndërtimin e objekteve për deponimin e mbeturinave të rrezikshme bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës në vitin 2010. Si rrjedhojë, projekti është përfshirë në të ashtuquajturin Instrument i BE-së për Ndhimën e Para-Anëtarësimin (IPA) për 2015. Për ndërtimin, qeveria fillimisht kishte identifikuar një parcelë toke brenda kompleksit të vjetër ushtarak në Harilaq në Fushë-Kosovë, e cila, pas studimeve paraprake, nuk ka dalë të jetë e përshtatshme për shkak të

mjeteve të pashpërthyer dhe bunkerëve të vjetër, duke e bërë të pamundur ndërtimin.

Pas disa kërkesave nga ana e BE-së në Kosovë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kishte identifikuar një lokacion alternativ brenda komunës së Fushë-Kosovës. Megjithatë, Kuvendi i Komunal i Fushë-Kosovës e pati refuzuar ngritjen e objektit në territorin e saj, duke mos i lënë kështu BE-së opsion tjetër, veçse ta anulohet projektin. "Pa parcelë toke të identifikuar nuk është më e mundur të bëhet Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, projektimi i hollësishëm dhe të përgatitet dosja e tenderit dhe procedura përkatëse përzgjedhëse për kryesin e punëve brenda afatit të kontratës, që është 15 dhjetor 2019. Në këtë pikë, thjesht nuk ka kohë për identifikim të një parcele të re dhe për kryerjen e



sërishme të të gjitha aktiviteteve përgatitore si gjeologjike, gjeoteknike, projektimi paraprak, konsultimet publike etj", është thënë deklaraten e Zyrës së BE-së në Kosovë.

Me këtë rast, BE-ja ka shprehur keqardhje për anulimin e këtij projekti pasi, sipas saj, i njëjti do t'i sillte përfitime të mëdha gjithë popullsisë, duke siguruar deponi të përshtatshme për mbeturinat e rrezikshme.

Aktualisht nuk ka një përkujdesje për këto mbeturina dhe, si të tilla, paraqesin kërcënim për shëndetin e njerëzve në mbarë Kosovën. "BE-ja kontribuon me pothuajse 100 milionë euro ndihmë financiare për Kosovën në vit. BE-ja mbetet e angazhuar të punojë ngushtë me Kosovën, përfshirë edhe me autoritetet lokale, për të investuar në një mbrojtje më të mirë mjedisore", është thënë në deklaraten e BE-së.

USAID-i do ta përkrahë rininë përmes një strategjie pesëvjeçare

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqyri Bytyqi, ka pritur të premtën në takim drejtoreshën e USAID-it në Kosovë, Lisa Magno, me të cilën ka diskutuar për projekte të rëndësishme të USAID-it në Kosovë dhe bashkëpunimin në të ardhmen.

Ministri Bytyqi ka theksuar në veçanti Programin e Transformimit të Liderit, përmes të cilit shumë të rinj janë arsimuar në universitet të njohura amerikane dhe kjo përvojë i ka shërbyer shumë zhvillimit të arsimit dhe Kosovës në përgjithësi.

Ministri Bytyqi ka falënderuar

Magno për angazhimin e deritanishëm të USAID-it në të gjitha fushat ku ka nevojë Kosova, veçanërisht në sistemin arsimor, ndërkaq ka kërkuar vazhdimin e projekteve edhe në të ardhmen. Ndërsa Lisa Magno, drejtoreshë e USAID-it në Kosovë, ka theksuar se thelbi i partneritetit në mes të USAID-it dhe Ministrisë së Arsimit është bashkëpunimi i mirë në mes të qeverive të dy vendeve.

Magno, po ashtu, foli edhe për hartimin e një strategjie pesëvjeçare, e cila në fokus të veçantë do ta ketë rininë, përkatësisht trajtimin e rinisë nga këndvështrimi i aftësisë për punësim, pjesëmarrjen në proceset politike etj.



Komandanti i ushtrisë u prit në Departamentin e Shtetit dhe Këshillin e Sigurisë Kombëtare



UASHINGTON 7 QERSHOR (ER) - Në vazhdim të vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) ka zhvilluar takime të ndara në Departamentin e Shtetit dhe në Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, i shoqëruar edhe nga ambasadorja e Republikës së Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, në Departamentin e Shtetit u pritën në takim nga Susan Falatko. Me këtë rast komandanti i FSK-së e ka njoftuar Falatkon për progresin e FSK-së në këtë fazë tranzicioni, mundësitë për

rritje të bashkëpunimit në mes të dy vendeve mike me qëllim të vazhimit të ndërtimit të aftësive të reja në bazë të planit gjithëpërfshirës për tranzicionin e FSK-së.

Gjithashtu, gjeneral Rahman Rama u prit edhe nga John Erath, zëvendës drejtor për Evropë, i shoqëruar edhe nga drejtori për Çështje të Evropës, Williem Berkley.

Gjeneral Rama i ka njoftuar zyrtarët e Këshillit të Sigurisë Kombëtare se FSK-ja vazhdon të jetë forcë profesionale, shumetnike dhe e gatshme për të qenë pjesë e misioneve

paqeruajtëse.

Zhvillimet dhe zgjerimi i mandatit të FSK-së është në përputhje me planin.

Në fund, komandanti i Ushtrisë së Kosovës ka falënderuar zyrtarët amerikanë në Departamentin e Mbrojtjes dhe Këshillin e Sigurisë Kombëtare për mbështetjen e vazhdueshme që ShBA-ja dhe Ushtria Amerikane po ia japin Kosovës dhe FSK-së.

Komandanti në të gjitha takimet ishte i shoqëruar nga atasheu i ShBA-së në Kosovë dhe atasheu i Mbrojtjes nga Republika e Kosovës në Uashington.

Vihet gurthemeli i sallës së sporteve në shkollën 'Ibrahim Banushi' në Shalë të Lipjanit

LIPJAN, 7 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqyri Bytyqi, mori pjesë në shënimin e Ditës së Shkollës "Ibrahim Banushi" në fshatin Shalë të Lipjanit, ku me këtë rast është bërë edhe vënia e gurthemelit të Sallës së Sporteve, e cila është investim i MASHT-it.

Ministri Bytyqi tha se kjo sallë po fillon të ndërtohet me qëllim të

përmirësimit të kushteve për edukim dhe argëtim të nxënësve dhe motivim të mësimit në mënyrë të përkushtuar për përgatitjen e gjeneratave të reja, të cilat do të kontribuojnë jo vetëm në këtë komunë, por edhe më gjerë. Ai i ka uruar të pranishmit për këtë ditë të rëndësishme dhe i ka ftuar mësimit për një angazhim sa më të madh në

edukimin e brezave të rinj, duke u premtuar atyre krijim të kushteve sa më të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe sportive.

Ministri, po ashtu, premtoi se MASHT-i do të vazhdojë të përkrahë këtë shkollë në aspektin e infrastrukturës dhe në aspekte të tjera, në mënyrë që të krijohet ambient për edukim të mirëfilltë.



Vdes një i burgosur derisa ishte duke shfrytëzuar fundjavën

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar të premtën se ka ndërruar jetë i burgosuri me iniciale M. M., i lindur më 1981. "Për vdekjen e tij jemi

njoftuar sot rreth orës 05:15 nga Policia e Kosovës. I burgosuri në fjalë, bazuar në legjislacionin në fuqi, kishte të drejtë shfrytëzimi të përfitimeve dhe po shfrytëzonte

dy ditë të fundjavës të rregullt në shtëpi, nga 05.06.2019 deri më 07.06.2019. I njëjti po vuante dënimin në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë dhe ishte i dënuar për Veprën

Penale Vjedhje e Rëndë. Me rastin në fjalë po merret Policia e Kosovës", është bërë me dije në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.



Veseli thotë se qindra miliona euro do të orientohen në inovacion dhe ndërmarrësi

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, të premten ka marrë pjesë në hapjen e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Ferizaj, me ç'rast ka thënë se pas përfundimit të autostradave moderne si bazë infrastrukturore për zhvillim ekonomik, Kosova tani do t'i orientojë qindra miliona euro investime për zhvillimin ekonomik nëpërmjet mbështetjes së ndërmarrësve dhe inovatorëve të rinj në Kosovë. "Tani do t'i përfundojmë autostradat, infrastrukturë kjo e cila ka ngjallur debat, por që ka qenë e domosdoshme për zhvillimin e vendit tonë. Por tani është pjesa më thelbësore. Qindra miliona euro do të orientohen kah inovacioni dhe ndërmarrësia,

kah njerëzit që e duan vendin dhe duan të punojnë për vendin. Kah ata që kanë dëshirën ta përmirësojnë jetën jo vetëm të familjeve të tyre, por edhe të bashkëqytetarëve. Këtu do të jetë edhe roli ynë", ka theksuar Veseli. Kryetari i Kuvendit u ka bërë thirrje të rinjve që të kenë më shumë besim në shtetin e tyre ngaqë, siç ka thënë Veseli, ky shtet është i shenjtë. Veseli ka theksuar se nuk është koha për debate shterpe, për të treguar se kush është më i fortë dhe më patriot në raport me Serbinë. "Patriotizmi sot është orientimi kah gjërat aktuale, e kjo është perspektiva dhe zhvillimi ekonomik, si dhe dhënia mundësi njerëzve punëtorë dhe me ideatorë. Këtë përkrahje do t'ua japim nëpërmjet institucioneve tona, duke rritur punësimin dhe të mirat materiale", është shprehur Veseli.



LV-ja: Tekstet shkollore po bëhen për klientelë, jo për nxënës

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbështetur profesionistët dhe organizatat e fushës të cilët kanë reaguar dhe informuar mbi gjendjen e rëndë në procesin e hartimit të teksteve të reja shkollore. Sipas tyre, tekstet shkollore janë përdorur nga drejtuesit e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë për interesa klienteliste me kompanitë private botuese dhe jo për garantimin e cilësisë së teksteve për nxënësit tanë. Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, ka shpjeguar joseriozitetin e procesit të vlerësimit të teksteve. Ajo ka thënë se recensentët e konfirmuar për t'i vlerësuar tekstet e shtëpive botuese konkurrense vijnë nga të njëjtat shtëpi botuese. "Madje, nuk kanë pasur as udhëzime për kriteret e vlerësimit dhe përshtatjen me kurrikulën e re. Skandali më i madh ishte mbledhja e tyre joserioze dhe e nxituar brenda një fundjave për përzgjedhjen e teksteve në një hotel, edhe pse formalisht procesi i vlerësimit duhej të zgjaste 45 ditë", ka theksuar ajo. Nagavci ka thënë se tekstet e reja kanë gabime përmbajtësore, didaktike dhe teknike. Sipas saj, kanë pasaktësi shkencore, përzjerje konceptesh dhe

gabime të tjera. "Nuk ka tematikë e ushtrime që nxisin ndërthurjen e dijeve të fushave të ndryshme ndërkurrikulare. Ka raste kur recensenti ka rekomanduar që teksti të mos licencohet dhe, megjithatë, teksti është shpallur fitues. Vetëm në njërin prej teksteve janë numëruar 39 gabime faktike. Recensentëve u është kërkuar të mos i bëjnë publike lëshimet. Vetë Këshilli për tekstet nuk nxori raport përfundimtar për shpalljen e fituesve dhe nuk ishte i përfshirë në asnjë fazë të procesit të vlerësimit, ndonëse e ka për detyrim ligjor. Përgjegjësia jashtëligjshëm u bart në individë brenda kabinetit të Ministrisë. Ministria tashmë e ka pranuar se disa tekste po botohen pa miratimin e Këshillit", është shprehur Nagavci.

Kurse deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka treguar natyrën klienteliste të këtij procesi. Ai ka theksuar se për shkak të shkeljeve nga ministria, shumica e anëtarëve të jashtëm të Këshillit për tekstet shkollore dhanë dorëheqje ose u larguan duke i paraqitur shkeljet edhe publikisht. "Në konkursin e publikuar mungonin përshkrimi dhe udhëzimet e nevojshme. Formalisht procesi i referohej kurrikulës së re dhe standardeve të teksteve shkollore që burojnë nga Ligji aktual për tekstet, por konkretisht nuk ka ndodhur kështu. Konkursi



është konceptuar gabim dhe me natyrë klienteliste pa ftuar studiues dhe profesionistë të fushës të konkurrojnë me tekstet e tyre. Shtëpive botuese private u është hapur rruga të kontrollojnë çdo pjesë të procesit", ka deklaruar Kurteshi. Ai ka theksuar se ministria ka qenë e interesuar të hapë një tender më shumë sesa një konkurs përmbajtësor. "Për interesat e tenderit nuk është

finalizuar projektligji në fjalë. Fondi për tekstet e reja mbërrin deri në 10 milionë euro, ku shumica përfitohen nga shtëpia botuese 'Dukagjini' e cila nga 46 dorëshkrime ka fituar 30 prej tyre. Siç ka sugjeruar publikisht eksperti Halim Hyseni dhe jo publikisht sh umë të tjerë, i gjithë procesi duhet të kthehet në pikën zero. Ministri duhet të japë përgjegjësi ligjore për vonesat, por tani edhe për këtë dësh-

tim total të përgatitjes së teksteve të reja. Cilësia e shkollimit të nxënësve tanë, por edhe financat publike po rrezikohen nga një proces i tillë i paligjshëm. Prandaj, do të thërrasim një seancë të jashtëzakonshme për t'u siguruar që ministri nuk vijon më tej me këtë proces dhe nuk e fut qeverinë në obligime të mëtejshme ligjore e financiare", është shprehur Kurteshi.

OECD-i vlerëson Kosovën për përparimin e bërë për zbatimin e aktit të biznesit të vogël

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 QERSHOR - "Zhvillimi i Biznesit të Vogël dhe të Mesëm është shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik të vendit", ka thënë ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, gjatë konferencës në të cilën është prezantuar raporti "Indeksi i Politikës së NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019". Ministri Shala ka theksuar se që nga marrja e mandatit është fokusuar me të gjithë dikasteret relevante që t'i krijojë të gjitha parakushtet e nevojshme për të zhvilluar, promovuar dhe forcuar ndërmarrësinë e Kosovës. "E bazoj këtë shkas duke vlerësuar rëndësinë e Aktit për Biznes të Vogël, respektivisht vlerësimin për Kosovën, sepse bizneset e vogla dhe të mesme prodhojnë shumicën e vendeve të punës dhe të ardhurave në vendin tonë. Prandaj, duke nënvizuar se bizneset e vogla kanë përballuar barrën më të madhe të këtij procesi të tranzicionit zhvillimor, me qëllimin që t'ua bëjmë më të lehtë funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarive të tyre", ka deklaruar Shala. Shala ka pohuar se janë iniciuar një sërë masash që ndikojnë në mënyrë graduale të zhvillimit të ndërmarrësisë, duke për-

mirësuar qasjen në financa, përmes fondit për garantim të kredive për ndërmarrjet e Kosovës. "Kemi filluar implementimin e programit mbështetës nga Banka Botërore për përmirësimin dhe certifikimin e produkteve kosovare me standarde evropiane dhe kualitetit të tyre për t'i ndërkombëtarizuar ato. Kemi dyfishuar organizimin e pjesëmarrjes së kompanive kosovare në panire ndërkombëtare me qëllim gjetjen e bashkëpunëtorëve dhe tregjeve të reja për eksport. Kemi themeluar skemën për mbështetje direkte/subvencionim të NVM-ve për blerjen e makinerisë dhe instalimin e teknologjive të reja prodhuese. Kemi krijuar mekanizma që ndikojnë drejtpërdrejt në krijim të një tregu të qëndrueshëm konkurrues. Kemi rritur inspektimet që konsumatori të jetë i mbrojtur", ka deklaruar Shala. Shala ka bërë me dije se përkrahja e NVM-ve do të vazhdojë të mbetet fokus i MTI-së duke përkrahur ato në rritjen dhe avancimin e teknologjive të reja prodhuese, duke inkurajuar ndërkombëtarizimin e produkteve të tyre. "Në të njëjtën kohë duke krijuar lehtësira të vazhdueshme për eksport si dhe duke negociuar dhe arritur marrëveshje



tregtare për qasjet në tregje të reja, dhe duke realizuar të gjitha rekomandimet dhe vlerësimet që vijnë nga partnerët tanë ndërkombëtare. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes programeve konkrete vazhdon të punojë në ngritjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve të Kosovës. Nga të pranishmit, presim që në fund të këtij takimi ta marrim rekomandimin e publikimit me qëllim të përmirësimit të

dimensioneve për aty ku mund të jenë evidentuar hapësira për përmirësim", është shprehur ministri Shala. Ndërsa Riccardo Serri nga Zyra e Bashkimit Evropian ka thënë se duhet të ngritet sektori i NVM-ve, sepse sipas tij, ky sektor është shumë i rëndësishëm jo vetëm për BE-në, por edhe për Kosovën. Edhe Marzena Kisieleska, udhëheqëse e Divizionit të Evropës Juglindore, tha se refor-

mat në këtë sektor janë zhvilluar me efikasitet. "Puna është duke u kryer në mënyrë efikase. Kam një mesazh optimist sepse ka pasur përparim në rajon dhe duhet të jeni krenarë jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Kjo nënkupton se pritjet edhe më shumë nga ju", ka deklaruar Kisieleska. OECD-i ka vlerësuar se Kosova është ndër vendet që ka bërë përparim të madh në zbatimin e aktit të biznesit të vogël.

MPMS-ja dhe UNDP-ja hapin 'Panairin e Vetëpunësimit 2019'

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) të premtën kanë hapur "Panairin e Vetëpunësimit 2019", i cili do të zgjasë deri më 8 korrik. Në panair po marrin pjesë mbi 80 biznese të reja, të themeluara nëpërmjet programit të vetëpunësimit e të cilat po prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, është shprehur i lumtur me suksesin e përbashkët të MPMS-së dhe UNDP-së në mbështetje të qytetarëve punëkërkues në Kosovë në masa aktive të tregut të punës, të cilët janë kthyer në vende pune afatgjatë e të qëndrueshme. "Ne si MPMS nuk do të ndalemë së mbështeturi qytetarët tanë, me qëllim të ngritjes së punësueshmërisë në vend dhe një nga prioritetet tona, siç

e kemi potencuar edhe në planin e punësimit të rinjve, është që ta rrisim punësueshmërinë, ta përmirësojmë tregun e punës, t'i aftësojmë profesionalisht të rinjtë në bazë të nevojave të tregut të punës dhe njëkohësisht t'i mbështesim nëpërmjet masave aktive të tregut të punës", ka deklaruar Reçica. Ndihmësja e përfaqësueses së përhershme të UNDP-së në Kosovë, Valbona Bogujevci, ka theksuar se programi i vetëpunësimit është pjesë e programit për masat aktive të tregut të punës që financohet nga MPMS-ja, që ka për qëllim që ta promovojë vetëpunësimin si një masë që është treguar e qëndrueshme. "Ka për qëllim t'i asistojë të rinjtë që t'i themelojnë bizneset e veta të vogla në mënyrë sa më të suksesshme dhe të qëndrueshme dhe programi gjithashtu ndihmon përfituesit e programit në vazhdimësi nëpërmjet këshillimit gjatë gjithë procesit", ka theksuar Bogujevci. Gjatë panairit Reçica dhe



Bogujevci bënë edhe lansimin e fazën së re të Programit të Vetëpunësimit, nëpërmjet të

cilit do të mbështeten 200 punëkërkues të riadhesuar në tërë Kosovën dhe 50

punëkërkues të rregullt në rajonin e Prishtinës dhe Mitrovicës.

Oda Amerikane prezanton potencialet për investime në Kosovë edhe në Britani

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Në konferencën "Vështrim mbi Kosovën" të organizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Emerging Europe në partneritet me Raiffeisen Bank Kosova dhe Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë të mbajtur në Londër, investitorët britanikë patën mundësi të njihen me potencialet për investime që ofrohen në Kosovë.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, në konferencë ka thënë se Kosova ofron potenciale të shumta për investitorët e huaj në përgjithësi dhe ata britanikë në veçanti. Këto potenciale në fushën e teknologjisë informative e deri te prodhimitaria e lehtë, të kombinuara me fuqinë e re punëtore si dhe reformat e vazhdueshme në mjedisin e të bërit biznes, e

bëjnë vendin atraktiv për investitorët e huaj.

Drejtori i Odës Amerikane foli për Zonën e Veçantë Ekonomike Amerikane si një model unik i zonave të lira ekonomike, i cili synon t'i tërheqë investitorët amerikanë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe investitorët e tjerë amerikanë që tashmë janë të pranishëm edhe në Britani të Madhe. Ai tha se kompanitë prodhuese amerikane dhe evropiane duhet t'i shohin mundësitë që dalin nga qasja e lirë e Kosovës në tregun e Bashkimit Evropian përmes MSA-së, respektivisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes sistemit të përgjithësuar të preferencave që mundëson eksportimin e mbi 3 500 produkteve nga Kosova pa doganë.



Mbahet takimi i radhës i grupit punues për tregun energjetik Kosovë - Shqipëri



PRISHTINË, 7 QERSHOR - Është mbajtur takimi i radhës i grupit punues për integrimin e tregut energjetik në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Në këtë takim ishin të pranishëm zëvendësministri i Zhvillimit Ekonomik, Xhavit Zariqi, Dorina Çinari, zëvendësministre e Ministrisë së

Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, përfaqësues nga USAID-i dhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë si dhe anëtarët e grupeve të përbashkëta teknike.

Zëvendësministri i Zhvillimit Ekonomik, Xhavit Zariqi, ka kërkuar që nga ky takim të

identifikohen barrierat të cilat po e ndalojnë këtë bashkim të tregut. "Mendoj se është shumë e rëndësishme të identifikohen barrierat në këtë iniciativë të përbashkët në mënyrë që ky proces të ecë me dinamikë të përshpejtuar", ka thënë ai. Gjithashtu, Zariqi ka përshënde-

tur aktin e themelimit të Bursës së Energjisë të aprovuar nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë më 15 maj dhe ka kërkuar që operacionalizimi i Bursës të përfundojë brenda këtij viti. "Së fundmi Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ka aprovuar aktin për themelimin e Bursës së Energjisë.

Mendoj se ky është një element kyç që ky proces të marrë një dimension të ri. Për atë them se ky momentum i ri duhet t'i dinamizojë hapat, që faza e parë e këtij procesi, që është themelimi i tregut një ditë para, të përfundojë brenda këtij viti kalendarik", ka thënë Zariqi.

Gjatë këtij takimi frytdhënës grupi punues ka diskutuar në detaje rreth ngecjeve dhe ndryshimeve të mundshme legale dhe teknike të cilat do të mund ta jetësonin bashkimin e tregut energjetik Kosovë - Shqipëri. Aty u vendosën edhe detyrat të cilat duhet të përfundohen deri në takimin e radhës në kuadër të planit të përbashkët. Të dyja palët vlerësuan se asistencat teknike nga USAID-i në këtë proces mbetet shumë e rëndësishme dhe falënderuan projektet përkatëse për mbështetjen e dhënë në këtë proces. Të gjithë u pajtuan se ky integrim bilateral është hapi i parë drejt integritit rajonal, obligim ky edhe në kuadër të procesit të integritit vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme lejon përmbylljen e procesit të likuidimit për KB 'Përlepnicë'

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka njoftuar se ka pranuar një aktvendim të lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) me të cilën lejohet përmbyllja e procesit të likuidimit për GJI019 Kooperativa Bujqësore "Përlepnicë" me seli në Përlepnicë - Gjilan. Agjencia, në pajtim me ligjin, më

parë ka parashtruar kërkesë në Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për aprovim të raportit përfundimtar dhe rrjedhimisht lejimin e mbylljes së procesit të likuidimit për këtë KB, ndërsa Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës përmes këtij aktvendimi e ka aprovuar këtë raport përfundimtar dhe ka dhënë leje për mbylljen e procesit të

likuidimit për KB-në e lartcekur. "Si rrjedhojë, pas aktvendimit të fundit të DhPGJSK-së, numri i NSh-ve për të cilat deri më tani është përmbyllur procesi i likuidimit në tërësi ka arritur në 32 NSh. Njëkohësisht, Gjykata ka caktuar një afat prej 21 ditësh për ndonjë ankesë eventuale ndaj këtij Aktvendimi dhe pas kalimit të këtij afati ky aktvendim bëhet i plotfuqishëm

dhe njoftimet për përmbyllje të likuidimit për këtë subjekt Agjencia Kosovare e Privatizimit do t'ua dërgojë institucioneve relevante ashtu siç parashihet me Ligjin e AKP-së", është thënë në njoftimin e AKP-së. Pas kalimit të afatit ligjor të ankesave, raporti përfundimtar do të postohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.



Bahtiri bën thirrje që të pengohet kolonizimi i mëtejshëm i veriut

MITROVICË, 7 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në takim përfaqësuesit e Lagjes "Kroi i Vitakut", Skender Rama, Ramadan Ademi si dhe Musa Haliti, të cilët e kanë njoftuar kryetarin Bahtiri se serbët në atë pjesë kanë filluar ndërtimin e disa shtëpive dhe kjo është e papranueshme nga ana e tyre, pasi asnjë shtëpi e banorëve serbë nuk duhet të ndërtohet përderisa nuk lejohet ndërtimi i shtëpive të shqiptarëve në atë pjesë.

Skender Rama, banor i lagjes "Kroi i Vitakut", ka kërkuar që

shqiptarët nga pjesa veriore e Mitrovicës duhet ta kenë mbështetjen e nivelit qendror për një jetë stabile dhe të qëndrueshme. "Ne si banorë të kësaj lagje kemi qenë gjithmonë për bashkëjetesë, mirëpo asnjë shtëpi e banorëve serbë nuk duhet të ndërtohet përderisa nuk lejohet ndërtimi i shtëpive të shqiptarëve dhe ne me mundësitë tona do të vazhdojmë pengimin e punimeve", ka thënë Rama. Ai ka bërë me dije se të gjithë banorët shqiptarë janë të pajtimit që të iniciojnë një peticion me të cilin do të kërkohet nga insti-

tucionet e nivelit qendror që të pengohet ndërtimi i banesave dhe shtëpive serbe. Kryetari Bahtiri i cili me shumë vëmendje ka dëgjuar shqetësimet e këtyre banorëve ka thënë se në të gjitha takimet e tij me përfaqësues të nivelit qendror dhe ndërkom-bëtar ka ngritur zërin për 13 000 shqiptarët e dëbuar me dhunë nga veriu i Kosovës, veçanërisht nga pjesa veriore e Mitrovicës, të cilët ende nuk janë kthyer në shtëpitë e tyre, ndërkohë vazhdojnë të jetojnë si refugjatë në pjesën jugore të qytetit dhe qytete të tjera të Kosovës.



Vazhdojnë zgjedhjet për kryetar të fshatrave të Ferizajt

FERIZAJ, 7 QERSHOR (ER) - Komuna e Ferizajt është duke mbajtur zgjedhjet për kryetarë të fshatrave të kësaj komune. Në kuadër të këtij procesi janë mbajtur zgjedhjet në fshatrat Softaj dhe Papaz. Kryetar i fshatit Softaj është zgjedhur Liridion Aliu, ndërsa në fshatin Papaz kryetar është zgjedhur Besim Sedolli. Procesi për zgjedhjen e kryetarëve të

fshatrave dhe zonave urbane është shpallur nga kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ndërsa është duke u zhvilluar konform Rregullores për bashkëpunim të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe zonat urbane. Zgjedhjet për kryetarë të fshatrave janë mbajtur edhe në këta fshatra: Dardani, Zllatar dhe Sojevë.



Komuna e Skenderajt angazhohet për mirëmbajtje të hapësirave publike

SKENDERAJ, 7 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt, e cila drejtohet nga Bekim Jashari, ka shtuar angazhimin për mirëmbajtjen e hapësirave publike në qytet. Kjo komunë ka theksuar se pastrimi i rrugëve dhe mirëmbajtja e hapësirave publike është obligim institucional.

"Mirëmbajtja e parqeve në qytet, duke kositur barin dhe pastruar çdo pjesë nga papastërtia, pastrimi i rrugëve dhe aktivitetet e tjera nga shërbimet tona publike, janë obligim yni institucional. Komuna ka shtuar angazhimin për t'i arritur objektivat e

përgjithshme, pra të kemi ambient të pastër, kurse nga ana e qytetarëve kërkohet t'i ruajnë këto hapësira. Vetëm duke bashkëpunuar ngushtë ia arrijmë qëllimit për një ambient të pastër. Skenderaj meriton të jetë i tillë!", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.

Prizreni shton hapësirat gjelbëruese

PRIZREN, 7 QERSHOR (ER) - Drejtoria e Shërbimeve Publike, përkatësisht Sektori i Mjedisit, vazhdon realizimin e aktiviteteve të ndryshme për nder të Ditës Botërore të Mjedisit. Në këtë kuadër, me intensitet të lartë po zhvillohen punimet për mbjelljen e fidanëve drunorë, ku tanimë edhe Qendra Sportive "Sezai Surroi" do të ketë një pamje më

të gjelbër. Komuna e Prizrenit do t'i vazhdojë punimet për rregullimin dhe krijimin e hapësirave gjelbëruese, ndërkaq të premtën në parkun e qytetit është organizuar edhe një aktivitet solemn ku, pos të tjerash, janë shpallur fituesit e ballkonit më të bukur me lule, kopshtit më të rregulluar, rrugës më ekologjike dhe lagjes më të pastër.



Shkrim drejtuar gazetarëve dhe atyre që merren me politikë

GJENOCIDI DHE TERMI 'SHFAROSJE'



Bardhyl MAHMUTI

Që në fillim më duhet ta përmendi dallimin që ekziston ndërmjet kuptimit të fjalës shqipe "shfarosje" dhe përdorimit të kësaj fjale në dokumentet e të drejtës penale ndërkombëtare.

Në gjuhën shqipe fjala "shfarosje" ka kuptimin e zhdukjes së tërësishme ose asgjësimit të njerëzve dhe qenieve të gjalla. Kjo fjalë është përdorur për të përkthyer një kategori juridike të së drejtës penale, për të cilën në gjuhën angleze, atë frënge dhe disa gjuhë të tjera përdoret fjala "extermination".

Fjala "extermination" ka prejardhje nga fjala latine "exterminare", e cila përbëhet nga dy fjalë: fjala "ex", që do të thotë "jashtë", dhe fjala "terminus", që do të thotë "kufij", "fund" dhe ka kuptimin e "përndjekjes përtej kufijve".

Fjala "extermination" mund të ketë kuptime të ndryshme edhe në gjuhët që e përdorin. Por ajo që është me rëndësi për temën tonë ka të bëjë me faktin se termi "extermination" në të drejtën penale ndërkombëtare ka fushën kuptimore të përkufizuar qartë dhe në kuadër të fushës juridike duhet t'i përmbahemi me përpikëri këtij përkufizimi. Në Statusin e Gjykatës Penale

Ndërkombëtare me nocionin "extermination" përkufizohet imponimi i qëllimshëm i kushteve të tilla të jetesës, si mungesa e ushqimit dhe e barnave, të parapara që të shkaktojnë shkatërrimin e një pjese të popullatës [Statusi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Neni 7, paragrafët 1 dhe 2, pika (b) në të dy paragrafët].

Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare është përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe mund të konsultohet përmes internetit (<http://www.legal-tools.org/doc/2ede1c/pdf/>).

Në këtë statut kategoria juridike "extermination" është përkthyer me fjalën shqipe "shfarosje". Nuk kam asgjë kundër pse është përdorur kjo fjalë për nocionin "extermination". Mirëpo kur fjala "shfarosje" përdoret në kuadër të përshkrimit të krimeve që janë të përkufizuara me të drejtën penale ndërkombëtare, atëherë, kjo fjalë nuk mund të ketë kuptimin e zhdukjes së tërësishme apo asgjësimit të njerëzve.

Në këtë kontekst, "shfarosja", si kategori juridike, ka vetëm kuptimin e imponimit të qëllimshëm të kushteve të tilla të jetesës, si privimi në ushqim dhe barna, të parapara që të shkaktojnë shkatërrimin e një pjese të popullatës. Dhe si krim hyn në kuadër të krimeve kundër njerëzimit.

Sa i përket shprehjes "kushte të jetesës", në dokumentin zyrtar të Kombeve të Bashkuara të titulluar "Elemente të krimeve", në pjesën kushtuar "Gjenocidi

nëpërmjet nënshtrimit të qëllimshëm të grupit në kushte të jetesës që do të shkaktonin shkatërrimin fizik të tërësishëm ose të pjesshëm të grupit", sqarohet se "pa u kufizuar vetëm në këto veprime, shprehja kushte të jetesës mbulon aktet e qëllimshme që privojnë nga gjërat e domosdoshme për të mbijetuar, si ushqimi, shërbimet mjekësore, dëbimi sistematik nga vendbanimet" (É l é m e n t d e s c r i m e s , Courpénaleinternationale, 2011, f.3, shënimi në fund të faqes). Në të dy citatet e Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare fjalën "POPULLATË" e kam shkruar me shkronja të mëdha, me qëllim që të vë theksin në një element që është thelbësor në cilësimin e krimeve.

Në rastet kur kemi të bëjmë me krime që janë kryer gjatë sulmeve të përmasave të gjera dhe sistematike të drejtuara kundër cilësdo popullatë civile, me paramendim që të kryhen aktet e parapara në Nenin 7, paragrafi 1, të Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, në mesin e të cilave edhe shfarosja, atëherë, kemi krim kundër njerëzimit.

Mirëpo nëse imponimi i kushteve të tilla të jetesës bëhet me qëllim që të shkatërron një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar, atëherë, kemi të bëjmë me krimin e gjenocidit.

Në "Elemente të krimeve", të përmendur më lart, precizohet:

1. Autori i krimit nënshtron një ose më shumë persona në rrethana të caktuara jetese.
2. Personi apo personat në fjalë i

takojnë një grupi të veçantë kombëtar, etnik, racor ose fetar.

3. Autori i krimit ka për qëllim që të shkatërrojë tërësisht ose pjesërisht këtë grup kombëtar, etnik, racor ose fetar, si të tillë.

4. Kushtet e jetesës duhet të provokojnë shkatërrimin e tërësishëm ose të pjesshëm të këtij grupi..." (É l é m e n t d e s c r i m e s , Courpénaleinternationale, 2011, f.3).

Vlen të theksohet se kur bëhet fjalë për nënshtrimitin e qëllimshëm të grupit në kushte të jetesës që do të shkaktonin shkatërrimin fizik të tërësishëm ose të pjesshëm të grupit, si element i krimeve të gjenocidit, nuk përmendet termi "shfarosje". Theksi vihet në privimin nga gjërat e domosdoshme për jetesë të anëtarëve të një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar, si i tillë. Me një fjalë, kur vrasjet, dhunimet, dëbimet e dhunshme në funksion të spastrimit etnik, imponimi i kushteve që shkaktojnë shkatërrimin njerëzor bëhen me qëllim që të shkatërrohet tërësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar, atëherë kemi të bëjmë me krimin e gjenocidit.

Prandaj kur flasim për krimet e forcave serbe gjatë luftës në Kosovë, sa herë të përdoret shprehja "popullata civile" duhet ta precizojmë se bëhet fjalë për civilë shqiptarë. Përndryshe, e zhvendosim krimin e gjenocidit në një kategori tjetër penale.

Për ilustrim do të përmend faktin se gjatë luftës në Kosovë, vetëm në vitin 1998, Serbia imponoi kushteve të tilla të jetesës që rrezikuan jetën e qindra mijëra

shqiptarësh.

Dhuna e ushtruar nga forcat e armatosura serbe, në kuadër të zbatimit të politikës së gjenocidit në Kosovë, pati për pasojë zhvendosjen e 230 mijë personave, që kishin qenë të detyruar t'i braktisnin shtëpitë e tyre. Sipas Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara, nga ata që ishin zhvendosur në brendësi të Kosovës, 50 mijë shqiptarë ishin pa çati mbi kokë dhe në mungesë të gjërave elementare. Fakti se dimri po afrohej shtonte brengosjen deri në përmasa alarmuese. Përballë kësaj situatë, më 23 shtatorit të vitit 1998, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën nëpërmjet të së cilës "alarmonte për rrezikun e katastrofës humanitare në Kosovë" (Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, S/RES/1199 1998, 23 shtator 1998).

Duke u mbështetur në këto norma të së drejtës penale ndërkombëtare, në Kosovë kemi të bëjmë me gjenocid në përputhje me Nenin 6, paragrafi (c) i Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, sepse imponimi i kushteve të tilla të jetesës ishte bërë me qëllim që të shkaktojnë shkatërrimin fizik të tërësishëm ose të pjesshëm të kombit shqiptar.

Si konkluzion nga ajo që u tha më lart del qartë se jo "shfarosja", në kuptimin si përdoret në gjuhën e përditshme, por qëllimi për të shkatërruar tërësisht ose pjesërisht shqiptarët si grup kombëtar, etnik, ose fetar i ndryshëm nga serbët, përbën krimin e gjenocidit të Serbisë në Kosovë.

Kosova dhe Sllovenia, të gatshme për bashkëpunim në bujqësi

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Ministrja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Ziviq, ka pritur të premtën në një takim ambasadorin e Sllovenisë në Kosovë, Bojan Bertoncelj, me të cilin ka diskutuar për zhvillimin bujqësor dhe rural si dhe për programet zhvillimore të ministrisë për këtë vit.

Ministrja Ziviq gjatë këtij takimi e ka informuar atë me disa nga projektet bujqësore të cilat parashihen të realizohen gjatë mandatit të saj dhe me këtë rast ka theksuar edhe angazhimin e saj me partnerët e huaj në mënyrë që t'i shkëmbejnë përvojat në zhvillimin e sektorëve bujqësorë. Ajo shprehu gatishmërinë e saj për të vazhduar

bashkëpunimin me Slloveninë për t'i shkëmbyer përvojat bujqësore me qëllim të avancimit të mëtejshëm të sektorit.

Ndërsa ambasadori Bojan Bertoncelj vlerësoi raportet e deritanishme mes dy vendeve dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm në mes të dy vendeve, duke theksuar me këtë rast edhe gatishmërinë e tij për mbështetje për zbatimin e projekteve të ndryshme bujqësore në mes të shtetit slloven dhe MBPZHR-së. Me këtë rast, ambasadori ftoi ministren për një vizitë zyrtare në Slloveni për të marrë pjesë në takimin ndërministror që do të mbahet në këtë shtet në gusht të këtij viti.



FJALIM I MADH PËR KOSOVËN NË BEOGRAD



Ismet SYLEJMANI

Ajo që ngjau në parlamentin serb në Beograd në kryeqytetin e ish-jugosllavisë dhe të Serbisë, duket e pabesueshme!

Ngjarje e madhe ishte dhe do të mbetet fjalimi i deputetit e politikanit liberal demokrat serb në parlamentin e Serbisë në Beograd!

Fjalimi, mund të quhet me plotë të drejtë fjalim i madh i një seance parlamentare, fjalim muaji e viti, fjalim dekade e shekulli në parlamentin e Serbisë!

Një fjalim i tillë do të duhej të përshendetë nga çdo intelektual shqiptarë e nga çdo institucion relevant kombëtar, shkencorë e shtetërorë në Atdheun e Kombit tonë, brenda e kudo nëpër botë! Gjithashtu një fjalim i madh historik serb, sikur ky i z. Çedomir Jovanović, do të duhej të gjente mbështetje e përshendetje edhe nga individ e institucione relevante ndërkombëtare, shtete e kombe, qofshin miq apo kundërshtarë të çështjes shqiptare!

Aty ku dikur ka zhvilluar punimet e veta parlamenti i republikave jugosllave, aty ku dikur kanë folur e kanë vjellur helmë e vrerë kundër shqiptarëve njëri pas tjetrit shumë politikan antishqiptarë nga republikat dhe krahinat jugosllave, aty gjëmonte fuqishëm thirrja e përfaqesuesit të politikës së re moderne serbe, se populli shqiptarë në Kosovë, duhet ta ketë shtetin e tij dhe Serbia duhet ta njohë e ta ndihmojë këtë shtet, të pajtohet e të kontribuojë për këtë realitet të ri, në Ballkan!

Në atë parlament ku krimineli e xhelati Milosheviq ka mbajtur fjalimet më famkqija antishqiptare, apo edhe krimineli i luftës Sheshel, por presidentët serb Millutinović, Kostunica, Gjingjic, Tadiq, Nikoliq e edhe ky i sotmi Vuçiq, ndodhi fjalimi historik, më i madhi deri më tani për popullin shqiptar, më i madhi për Kosovën!

Pas bombardimeve historike të

NATO-s, por edhe pas Dronit të famshëm dhe pas vizitës historike të Kryeministrit Rama në Beograd, ky fjalim i këtij politikanit liberal e demokrat serb, është e do të mbetet ngjarja e katërt e madhe e pasluftës së UÇK-së!

Lufta heroike e titanike e UÇK-së në Kosovë, luftërat e ushtrive çlirimtare në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoninë e Veriut, janë luftërat e lavdishme të popullit shqiptar, janë epokat e mëdha të fund shekullit të vjetër dhe fillim shekullit të ri!

Për të dëgjuar, shikuar dhe lexuar në tv e mjete të tjera të informimit masiv, këtë fjalim brilant e qëndrim parimor internacionalist e në mbështetje të aspiratës shekullore të popullit shqiptar e luftës së tij të madhe dhe përpjekjeve të pandërprera për liri e pavarësi të Kosovës nga Serbia pushtuese, është dashur të kalohet nëpër shumë rrathë e nëpër një kalvar shumë të tmerrshëm të vuajtjeve e gjenocidit serb ndaj popullit tonë!

Në parlamentin serb, gjatë diskutimit fenomenal dhe heshtjes pothuaj totale të deputetëve, me perjashtim të zhurmsës së kriminelit Sheshel, u goditën për vdekje dhe u hodhën në koshin e plehrave planet, projektet dhe elaboratet antishqiptare të Qubrilloviqëve, Garashaninëve, Andriqëve, Pashiqëve, carëve, mbretërve e krajlëve serb, të cilët nuk lanë gjë pa bërë e gurë pa lëvizur, që të na vrisnin e masakronin, të na shpërngulnin e asimilonin, të na merrnin tokën e të parëve (edhe pse na morrën shumë nga ajo, Nishi, Toplica, Kurshumlia), që të na mundnin e tu dorëzoheshim përgjithmonë!

Çka e ka shtyrë me mbajtë një qëndrim të këtyllë këtë deputet serb trim e të vendosur?

Duhet ta themi hapur, e ka shtyrë

lufta e drejtë e gjigande e popullit shqiptar të Kosovës dhe viseve të saja, e ka shtyrë qëndresa dhe mospërkulja shekullore heroike e luftarake UÇK-së, e ka shtyrë qëndrimi trimërorë e kategorik, diplomatik e i panështruar, i shtetit dhe i kombit shqiptarë, dhe krejt në fund e ka shtyre përkrahja e madhe dhe e hapur që ia kanë bërë çështjes shqiptare aleatët tanë të mëdhenj SHBA, Anglia, Gjermania, Franca, Italia dhe shumë të tjerë, por edhe e kashtyrë politika antinjerëzore, antishqiptare dhe antieuroatlantike e strategjisë shfarosëse serbe, kundër Kosovës dhe popullit të saj të pambrojtur!

Dikur jo larg në të kaluarën, në CZ-në e Beogradit e nëpër burgjet tjera serbe, janë burgosur, torturuar e vrarë barbarisht me qindra e me mijëra shqiptarë vetëm e vetëm, pse vepronin e dëshironin që populli shqiptar dhe Kosova të mos ishte nën pushtimin serb.

Fjalimi ishte homazh e nderim për ata qindra e mijëra të burgosur politik shqiptarë që kanë vuajtur dhe lënë shëndetin, rininë dhe jetën e tyre nëpër kazamatet serbe!

Fjalimi i deputetit serb ishte homazh e nderim, për ato qindra e mijëra viktimat shqiptare nga Kosova, të cilat pasi u burgosen e u dhunuan, u vranë e u masakruan e pastaj u bartën me mjete transportuese të vdekjes dhe u hodhën në Danub e nëpër humnera të ndryshme nëpër serbi!

Atë ditë në parlamentin serb ëndrra e tillë, u bë realitet i madh, deputeti serb Jovanović, me qëndrim e tij dhe me oratorinë spektakulare, e konfirmoi në foltore përballë Presidentit të Serbisë, Kryetares së Parlamentit, Kryeminstres së Qeverisë e Ministrave të kabinetit qeveritar, para mjeteve të informimit e i transmetuar live nga Radiotelevizioni serb, pra para gjithë Serbisë e popullit serb brenda e jashtë kufinjve, deklaroi se duhet të pranohet realiteti i ri dhe të mos veprimë kundër interesave të popullit shqiptar, por t'i ndihmojmë në konsolidimin dhe ta njohim shtetin e Kosovës!

Populli shqiptar i Kosovës në veçanti dhe populli shqiptar në përgjithësi kudo që jeton dhe të gjithë brezat që do të vijnë, do të jenë mirënjohës e falenderues deputetit liberal internacionalist e patriot serb Çedomir Jovanović, për fjalimin e madh e historik dhe qëndrimin e mbajtur në mbrojtje dhe përkrahje të shtetit të pavarur e sovran të Kosovës, të njohur e të pranuar ndërkombëtarisht nga SHBA, BE e NATO!

Urojmë që asnjë e keqe të mos i ndodhë deputetit serb Jovanović, të mos burgoset, të mos i bëjnë atentate e të mos vritet për qëndrimin e tij brilant në mbrojtje të Kosovës! Gjithashtu urojmë që edhe atyre që i dalin në mbrojtje e mbështesin dhe ecin rrugës së tij, të mos ndiqen dhe asnjë e keqe të mos ju ndodhë!

Prishtinë, më 4 qershor 2019!



Biografi e shkurtër e heroit të Kosovës, Naser Krasniqi-Leka

Jeta dhe vepra e dëshmorit të kombit, Naser Krasniqi

Shkruan: Dr. Muharrem QAFLESHI

Të rrallë janë ata njerëz që tërë jetën e tyre ia kushtojnë çështjes kombëtare. Për ta, mbi të gjitha qëndron ideali i lartë, liria e popullit të tyre. Ata nuk kërkojnë as më pak e as më shumë, po vetëm që populli i tyre të ketë mundësi që të jetojë ashtu siç jetojnë të gjithë popujt në vendet e qytetëruara e demokratike të botës. I tillë ishte Naser Veli Krasniqi, i cili lindi dhe jetoj në fshatin e lindjes, Ratkoc të komunës së Rahovecit, nga prindërit Veli Krasniqi dhe Mihrije Xhyliqi-Krasniqi. Që në bankat shkollore shihej qartë se ishte ndryshe nga të tjerët, ngase ishte i pjekur shumë herët kombëtarisht. Qysh në klasën e 5-të, i motivuar nga familja, rrethi dhe shokët më të vjetër, e theu fotografinë e Titos (ish- kryetarit të Jugosllavisë), që në atë kohë ishte rrezik për të dhe familjen e tij. Shqiptarët gjatë viteve 1988/89 përjetuan kulmin e diskriminimit politik në Kosovë, kur serbo-jugosllavët suspenduan autonominë e Kosovës. E shqiptarët kësaj gjendjeje të rëndë iu kundërpërgjigjen me protesta, demonstrata dhe me mënyra të tjera të padëgjueshmërisë qytetare. Në kontekst të këtyre ngjarjeve, dëshmori Naser V. Krasniqi ishte njëri ndër protagonistët e protestës, protestuesit që me ditë dhe muajt nuk ndaluan së vepruari në demonstrimin fizik, organizativ, moral dhe shpirtëror. Kjo kohë edhe pse ishte e vështirë dhe kërkonte sakrificë, ai nuk ndalej. Në këto rrethana, Naseri u ballafaqua me rrezikun që kërcënohte, duke përjetuar kështu helmët e ndryshme të gazit lot-sjellës, e deri në rrahjet brutale që për çdo protestë ishin evidente. Ai, në këto demonstrate që vazhduan deri në fund të vitit 1989 dhe fillimi i vitit 1990, nuk u nda për asnjë moment, përkundrazi ai siç pohonin shokët e tij pjesëmarrës, iu jepte motiv me veprimet e tij dhe që nga ajo kohë vazhdimisht kërkoi nga policia. Por falë zhdërvjelltësisë së tij, policia armike asnjëherë nuk arriti ta vinte nën pranga. Veprimtaria patriotike e Naser Krasniqit, u identifikua shumë shpejt nga shërbimi sekret (UDB) si njërin ndër organizatorët dhe udhëheqësit e demon-

stratave, i cili u fotografua nga UDB-ja serbe, dhe u shpall në kërkim. Kjo e bëri që ai, në vend që t'i fillonte studimet në fakultet, mori rrugën e kurbetit në Gjermani. Naserin, si shtegtar të lirisë, e gjejmë përsëri në Kosovë, në vitin 1996, por tash edhe më të formësuar, më të pjekur, më të organizuar dhe më të brumosur me idealet e lirisë. Pas kthimit të tij në atdhe, pa humbur kohë vazhdoi veprimtarinë atdhetare fillimisht në fshatin e tij të lindjes Drinas, përmes organizatës ilegale të quajtur LKÇK, e më pas si student në Prishtinë.

Me t'u futur në LKÇ, Naseri



Naser Krasniqi -Leka

aktivitetin e filloi menjëherë me shpërndarjen e fletushkës "Çlirimi", organ propagandistik i LKÇK-së, si dhe me aktivitetet të tjera patriotike si bartja dhe sistemimi i njerëzve të ardhur nga shtetet Perëndimore për të luftuar për çlirimin e Kosovës, bartnin armatim, medikamente dhe gjëra të tjera që ishin më se të nevojshme për luftë.

Pra, Naseri me shokët e tij përmes vijës kufitare Kosovë-Shqipëri, i merrnin në kufi mërgimtarët luftëtarë, nga shokët që vepronin brenda Shqipërisë, të cilët i sistemoni në fshatin (Ratkoc), më pas i shpërndanin në zonat tjera të Kosovës. Në vitin 1996/1997, Naseri u regjistrua në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Prishtinës. Studimet i kishte më tepër mbulesë, edhe pse ishte student i zgjuar dhe shumë i aftë për profesionin që kishte zgjedhur, por për të gjithmonë në plan të parë ka qenë çështja kombëtare dhe në veçanti konsolidimi i radhëve për rezistencë të armatosur. Naseri, më 1 tetor të vitit 1997, ishte pjesëmarrës aktiv i protestave që u zhvilluan në Prishtinë, përkatësisht tek vendi i quajtur "Velania". Në këtë organizim të studentëve të UP-së, kolona e të cilit ishte i gjatë dhe masive, të cilave u prinin profesorët dhe studentët

e Fakultetit Filozofik, mirëpo rendi e donte që kësaj mase do të duhej t'i ruhej shpina, dhe në bazë të kësaj përlogaritjeje Fakulteti i Kulturës Fizike ishte i fundit. Naseri, pas një veprimtarie të bujshme nën petkun e studentit të UP-së, në Prishtinë dhe pas shumë veprimeve me karakter atdhetar, duke filluar që nga propaganda, diskutimet me studentët, organizimet, masivizimet e deri të shpërndarja e gazetës "Çlirimi" dhe më gjerë, përfundimisht në muajt e parë të vitit 1998, e braktis qytetin e studentit, Prishtinën dhe kthehet në Anadrini, përkatësisht në fshatin e tij të lindjes, Ratkoc, për të filluar veprimtarinë luftarake, deri në rënie. Gjatë viteve 1997/98, Naseri së bashku me shokët, filluan bartjen masive të armatimit përmes kanalit të hapur që kishte krijuar LKÇK-ja, në kufirin Kosovë-Shqipëri. Armët dhe municionet barteshin me krah, deri poshtë tek fshatrat e Hasit të Kosovës, për t'i transportuar më pastaj edhe me mjete të tjera, si me kuaj, traktorë, kamionë, etj. Njësi gueril për bartjen e armatimit, pjesë e së cilës ishte edhe Naseri, shpesh i kujtonte ato ditë të vështira, por edhe të lumtura kur Naseri me cilësitë e veçanta që kishte u jepte zemër, guxim dhe kurajë shokëve dhe me urtësinë e tij e tejkalonte çdo pengesë që i paraqitej dhe kështu e bënte rrugën edhe më të lehtë. Me daljen publike të UÇK-së, në Drenoc të Rahovecit, më 26 prill të vitit 1998, u krijuan rrethana të reja edhe në rajonin e Anadrinit. Pra, u përshpejtua shtrirja e organizimit të një lufte legale. Pra, kjo ngjarje ndikoi që edhe njësi gueril i LKÇK-së, nga fshati Ratkoc, që deri më tani veproi në rrethana ilegale, tash dinte legalisht dhe t'u bashkëngjitej radhëve të UÇK-së, fillimisht në fshatin Drenoc. Të nesërmen, pikërisht më datën 27 prill 1998, Naseri së bashku me grupin që kishte prej



Naser Krasniqi -Leka. 24.X.72 - 04.VI.98

rreth 12 pjesëtarëve të armatosur të LKÇK-së, iu bashkuan Shtabit të UÇK-së, në Drenoc, duke u ardhur në ndihmë, dhe prej këtij momenti Naseri veproi legalisht.

Me shkuarjen në Drenoc, Naseri së bashku me dy shokë të tjerë vendoset në pikën më të lartë malore, në majën e Zatriqit, pasi konsiderohej si pika më strategjike për luftime. Qëndrimi i tij atje u përshkua me një sërë veprimesh, duke u organizuar, ushtruar dhe duke bërë roje nëpër pozicionet e UÇK-së. Naseri, derisa vepronte në Drenoc dhe në Zatriq, për herë të parë e përdor maskën. Në këto pika, Naseri veproi për rreth 15 ditë, derisa më datën 11 maj, një ditë

para 12 majit, ai me një grup bashkëluftëtarësh të UÇK-së, e ndjekin një kamion "Tamiç", pjesë e kolonës së motorizuar serbe deri në Gradish. Kolonat e motorizuara serbe, të datës 11 maj, i tërhoqën civilët serbë që banonin në fshatin Bratotin. Këtë e bënë për dy arsye. E para, për faktin se pozicionet e UÇK-së ishin shumë afër tyre, dhe e dyta, për faktin se të nesërmen planifikonin t'i sulmonin pozicionet e UÇK-së, në këtë terren. Për fat të keq, kjo kolonë serbe iu shmang ndjekjes së UÇK-së, dhe 11 maji përfundoi pa pasoja. Naser Krasniqi gjatë gjithë kohës mbante emrin e ilegalitetit dhe të luftës "Leka", të cilin ia kishin vënë shokët e njësitit gueril. Në historinë tonë etnike, emri Lekë është emër i njeriut që bëri epokë në jetën e kombit shqiptar, në drejtësi, urtësi, pastërti morale, hijeshi dhe në njerëzi. Shumë prej këtyre tipareve e virtyteve kanë ekzistuar te personaliteti i dëshmorit Naser Krasniqi - Leka. Më datën 12 maj, Naseri do të merrte pjesë aktive në luftë ballë për ballë me forcat serbo-jugosllave, në të cilën betejë pas 10 orë luftimesh të ashpra, ai do të shquhej me guxim dhe trimërinë e tij, nga një pikë në tjetrën, nga një front në tjetrin. Në këto përballime, do të shquhet luftëtari shembullor, i cili me guxim nxitoi aty ku kërkoi vetëmohimi dhe trimëria, gjithnjë shembull për bashkëluftëtarët, deri në ditën e rënies heroike. Nga data 12 maj 1998, Naseri do të transferohet nga Drenoci e Zatriqi në Ratkoc, për të vazhduar organizimin dhe luftimet që pasuan në vazhdim. Më 13 maj, strukturat udhëheqëse të UÇK-së morën vendim të vendoset pika në "Gradish", vend ky shumë i përshtatshëm për luftë, apo siç njihet në terminologjinë ushtarake, pikë



gjeostrategjike, sepse kontrollonte magjistralen kryesore Gjakovë-Prizren-Rahovec. Në bazë të urdhrave të shtabit, herët në mëngjes, rreth orës 5:00, u vendosën pozicionet e UÇK-së përgjatë tërë vijës së Gradishit. Naseri, së bashku edhe me disa shokë të tjerë, gjatë tërë natës u kujdesën për dërgimin e ushtarëve atje, si dhe përpqeshin që armatimin të kishin në sasi të mjaftueshme. Në orën 8.00, forcat serbe mësynë Kodrën e Gradishit, dhe natyrisht hasën në kundërpërgjigje nga UÇK-ja. Naseri me shokë, me të dëgjuar për luftimet që kishin filluar në Gradish, pa një pa dy, u ngrit në këmbë, mori armatimin dhe ia mësyu Gradishit. Dhe prej këtij momenti, Naseri përgjatë 12 orëve luftime qëndroi aktiv nëpër pozicionet e UÇK-së. Dëshmorin e kombit, Naser Krasniqi, deri në aktin e rënies, do ta shohim kudo nëpër aksione e fushëbeteja luftarake, si në Drenoc, Bratotin, Ratkoc, Zatriq, Vranjak, Dejë, Malësi e Vogël, Gradish, etj., ai, nuk iu frikësua vdekjes dhe nuk i bëri lak asaj. Naser Krasniqi, duke qenë në krye të detyrës, si çdoherë në mbremjen e 4 qershorit 1998, saktësisht në orë 9.26 minuta kur filloi një ofensivë e madhe altierike serbe e kombinuar me shumë forma lufte, pikërisht aty edhe ku lindi, në Drinas (ish- Ratkoc), në përballje me forcat serbe, bie heroikisht, duke mbrojtur dinjitetin kombëtar dhe lirinë e atdheut të vet.

Ai sa ishte gjallë sikur e parandiente vdekjen kishte thënë: "Unë do të vritem, por nuk i frikësohem vdekjes, sepse s'ka gjë më të mirë, e më krenare se sa vdekja për atdhe".

Më 04.06.2016, Prishtinë

E rrallë

Iu thye shishja e parfumit në këmbë, gruaja rrezikoi të vdiste

Një nënë e dy fëmijëve iu lut një kirurgu që t'i priste këmbën për shkak të një aksidenti të çuditshëm. Gill Haddington, 42-vjeçare, nga Morecambe, Lancashire, u dëmtua nga një shishe parfumi, i cili u rrëzua dhe ra te këmba e saj e djathtë në shtator 2015. Gruaja në ato

çaste ndjeu dhimbje të tmerrshme dhe bëri grafi për të parë nëse kishte ndonjë kockë të thyer. Gruaja u diagnostikua me sindromën e dhimbjes kronike rajonale. Gjendja quhet "sëmundja vetëvrasëse", sepse dhimbja i çon njerëzit në prag të vdekjes.



FOTO E DITES




Nxënësit në një rajon të Filipinës kanë përdorur styropoll për ta shndërruar në barkë pas vërshimeve në këtë vend për të shkuar në shkollë /AFP/

E jashtëzakonshme

Gjendet një krijesë misterioze në bregdet, habiten shkencëtarët

Një krijesë misterioze është gjetur në një plazh të Karolinës së Veriut. Ka qenë një kalimtar i rastit ai që zbuloi gjallesën e pazakontë, të mbuluar me gjemba. Në një postim në "Facebook", qytetari bëri thirrje për identifikimin e krijesës nga publiku. Pas postimit të fotografive, ekspertët e shërbimit të Parkut Kombëtar ende



nuk kanë mundur që t'i japin një emër kësaj gjallesë të gjetur në bregdet. Disa thonë se bëhet fjalë për një peshk të dekompozuar puffer.

BARSOLETA E DITËS



Një i dehur tapë po provonte ta hapte derën e banesës, por nuk ia arrinte.
- A të ndihmoj?, e pyeti fqinji.
- Jo, jo, ti veç mbaje ndërtesën të mos lëvizë, se e hapi vetë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Dashuria është ajo që ju ndjek gjatë gjithë ditës së sotme. Por, jeni ju që po tregoheni pak indiferentë në këto momente dhe nuk i kushtoni rëndësi.</p>	 <p>DEMI Ditë e çuditshme që më shumë do të merreni me udhëtime se me punën tuaj rutinë. Nuk jeni mësuar me këto ritme dhe dita sot do t'ju lodhë.</p>	 <p>BINJAKËT Sot do të jeni shumë korrektë me takimet, gjë që nuk ndodh zakonisht me ju. Në mbrëmje do t'ju pëlqejë surpriza që ka përgatitur partneri.</p>	 <p>GAFORRJA Po mundoheni të vendosni rregull në një vend që ka pllakosur kaosi. Nuk do t'ia dilni dot mbanë të vetëm kështu që kërkoni ndihmë.</p>	 <p>LUANI Duket sikur nuk po ju dëgjojnë dhe nuk po ju kuptojnë. Mbase është perceptimi juaj i gabuar sepse do të keni rezultate shumë të shpejta.</p>	 <p>VIRGJERESHA Mendime të kundërta ju turbulojnë mendjen dhe nuk dini se nga të pozicionoheni. Është mirë të dëgjoni zemrën ndonjëherë.</p>
 <p>PESHORJA Si në jetën në çift ashtu edhe në familje, këtë periudhë do të dilni si persona që nuk kënaqen kurrë. Ju thjesht doni të jeni perfektë në detaje.</p>	 <p>AKREPI Intuita sot nuk do t'ju lerë në baltë. Në shumë raste do të kishit gabuar po sot do të jeni mjaft përpara vetëm falë indicies që keni.</p>	 <p>SHIGJETARI Pak interes për të komunikuar me njerëzit sot dhe dëshirë mjaft e madhe për të qenë më afër me natyrën.</p>	 <p>BRICJAPI Sot do ta nisni ditën me këmbën e mbarë dhe po kështu do ta përfundoni. Duhet të falënderoni yjet që janë në anën tuaj këtë ditë.</p>	 <p>UJORI Megjithëse këtë periudhë jeni të mbingarkuar do të gjeni pak kohë për të kaluar në shoqëri të mirë. Miqtë janë referenca juaj për gjithçka.</p>	 <p>PESHQIT Këtë ditë do te keni logjikë të ftohtë në marrjen e vendimeve, por do të jeni dhe mjaft të ndjeshëm karshi personave që ju duan.</p>


Rita Ora falënderon disenjatorët për veshjen e saj



Këngëtarja e njohur me prejardhje nga Kosova, Rita Ora, me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram", i ka falënderuar disenjatorët që përkujdesen për veshjet e saj në koncerte. Ora ka theksuar se ata


bëjnë një punë të mrekullueshme me rrobat që ajo ka për të veshur. "Një falënderim shkon për grupin e stilistëve që kam, ata janë të mrekullueshëm, sepse ata bëjnë një punë të mrekullueshme me këtë veshje që kam", ka shkruar Ora.

Katy Perry nuk po nxiton të martohet



Katy Perry nuk po nxiton për ta planifikuar dasmën me Orlando Bloomin. Këngëtarja 34-vjeçare ka dhënë një intervistë për "Kiss Breakfast with Tom & Daisy", ku u pyet nëse kishte filluar me planifikimet e

dasmës. "Epo, po, ngadalë-ngadalë", ka thënë Katy. "Përfundimisht ta hedhim themelin e mirë emocional për këtë angazhim të jetës, që është një punë e madhe, e dini?", ka shtuar këngëtarja.



Cooper dhe Shayk, bashkë për hir të vajzës

Ditët e fundit është raportuar në media se lidhja disavjeçare e Bradley Cooper dhe Irina Shayk po shkon drejt fundit. Duket se këto shkrime nuk kanë mbetur vetëm në suaza të thashethemeve, pasi një burim shumë i afërt me çiftin ka theksuar se është vetëm vajza e tyre ajo që ende po i mban

bashkë. "Gjërat kohët e fundit dukeshin se po përmirësoheshin, por sapo Bradley dhe Irina filluan të qëndrojnë bashkë me njëri-tjetrin, kuptuan se të qëndruarit në një vend nuk është gjëja që duan për momentin. Ata duan të qëndrojnë afër për hir të së bijës, por nuk janë të lumtur për këtë", ka thënë ky burim.

Beyonce bëhet xhelozë për burrin e saj



Ata janë një nga çiftet më të famshëm në botë. Beyonce dhe Jay Z kanë shkuar së bashku për ta përcjellë ndeshjen e basketbollit të Golden State Warriors,

por një moment interesant ka ndodhur kur Beyonce ka shfaqur shenja xhelozie për bashkëshortin e saj Jay Z i cili shihet duke biseduar me një grua.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045 82 82 82

'EPOKA E RE' PËR HERË TË DYTË KAMPIONE E MEDIA LIGËS

Gazeta 'Epoka e re' e ka shkruar historinë në Media Ligë pasi është bërë ekipi i parë që e fiton dy herë trofeun e më të mirit. 'Epoka...' që nga fillimi e deri në fund të këtij edicioni të kësaj lige ishte ekip dominues dhe me plot meritë është shpallur kampione. Nga 30 ndeshjet e zhvilluara ky ekip arriti t'i regjistrojë 23 fitore, 4 barazime dhe 3 humbje. 'Infokusi' dhe 'Media Works'-i janë ekipet që kanë përfunduar kampionatin në pozitat dy dhe tre. Lojtari më i mirë i turneut është shpallur Erzen Zyberaj i 'Epokës së re', kurse epiteti i portierit më të mirë i ka takuar Arsim Popajt të 'Lajmi.net'

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Gazeta 'Epoka e re' ka arritur që me plot sukses ta mbrojë titullin e kampiones në Media Ligë. Pas triumfit në vitin 2010, 'Epoka e re' e fitoi edhe në këtë edicion titullin e kampiones, duke grumbulluar 73 pikë. Skuadra kampione e Media Ligës regjistroi 23 fitore, 4 barazime dhe 3 humbje. Fitorja më e thellë e saj e arritur në këtë edicion ishte ndaj 'D+' me rezultat 18-4. Risi ishte se Media Liga ka qenë me format të ri, pasi 16 skuadrat pjesëmarrëse janë përballur nga dy herë ndërmjet vete. Kapitani legjendar i 'Epokës së re', Sadik Zeqiri, është shprehur i kënaqur me paraqitjen e ekipit që i prin dhe është zotuar se edhe në edicionet e ardhshme 'Epoka e re' do të jetë një ekip pretendent për titull të kampionit. 'Sikurse në vitin 2010, edhe në këtë kampionat kemi qenë ekip stabil. Dëshmojnë rezultatet që kemi arritur. Jam i lumtur që kemi dalë të parët, pasi konkurrenca ka



qenë jashtëzakonisht e fortë, ku më së miri tregon fakti se secili ekip ka mundur ta mposhtë

ekipin kundërshtar. 'Epoka e re' do të jetë kandidate serioze edhe në kampionatet e ardhshme, ka thënë Zeqiri.

Media Liga filloi më 14 shtator me një rivalitet shumë të fortë dhe ekipi i 'Epokës së re' startoi me një barazim ndaj 'InfoKosova & PrishtinaPost' (6-6), por në ndeshjen e dytë kampionia në fuqi nga viti 2010, 'Epoka e re', iu gëzua fitores ndaj rivalit të drejt-përdrejtë për titull 'Media Works'-it, me rezultat bindës 8-1. Fitoret e 'Epokës...' vazhduan deri në xhiron e tetë, kur 'Lajmi.net', që deri në atëkohë ishte ndër skuadrat më të mira, arriti që në fund të ndeshjes të nxjerrë një barazim 3-3, pas një pakujdesie të kundërshtarit në minutat e fundit. Ky barazim nuk e humbi

motivin te djemtë e 'Epokës...', pasi ata e mposhtën 'RTK'-në me rezultat të thellë 8-1 dhe sërish u rikthyen në serinë e fitoreve deri në xhiron e trembëdhjetë, kur 'Gazeta Metro' arriti t'i befasojë, duke i mposhtur 1-0. Kjo ishte humbja e parë për skuadrën e 'Epokës së re', kurse sezonin vjeshtor ky ekip e mbylli në vendin e parë. Në sezonin pranveror 'Epoka e re' u rikthye me fitore, duke e mposhtur ekipin e 'InfoKosova & PrishtinaPost' me rezultat 5-4, por më pas erdhën dy dështimet e radhës, duke luajtur fillimisht baras me 'Media Works'-in (2-2) dhe duke pësuar edhe humbjen e dytë në kampionat, kësaj radhe nga 'Infokusi' (4-2). Një tjetër rezultat i papritur ishte

REZULTATET E 'EPOKËS SË RE'

'INFOKOSOVA & PRISHTINAPOST' - 'E. E RE'	6-6
'MEDIA WORKS' - 'EPOKA E RE'	1-8
'EPOKA E RE' - 'INFOKUSI'	3-2
'GAZETA ZËRI' - 'EPOKA E RE'	3-5
'ORA INFO' - 'EPOKA E RE'	2-15
'EPOKA E RE' - 'GAZETA BLIC'	10-4
'RTV DUKAGJINI' - 'EPOKA E RE'	1-4
'EPOKA E RE' - 'LAJMI.NET'	3-3
'RTK' - 'EPOKA E RE'	1-8
'EPOKA E RE' - 'KALLXO.COM'	8-0
'KLAN KOSOVA' - 'EPOKA E RE'	2-7
'EPOKA E RE' - 'KOSOVAPRESS'	5-2
'GAZETA METRO' - 'EPOKA E RE'	1-0
'EPOKA E RE' - 'D+'	18-4
'TELEGRAFI' - 'EPOKA E RE'	3-10
'E. E RE' - 'INFOKOSOVA & PRISHTINAPOST'	5-4
'EPOKA E RE' - 'MEDIA WORKS'	2-2
'INFOKUSI' - 'EPOKA E RE'	4-2
'EPOKA E RE' - 'GAZETA ZËRI'	4-2
'EPOKA E RE' - 'ORA INFO'	4-4
'GAZETA BLIC' - 'EPOKA E RE'	0-3
'EPOKA E RE' - 'RTV DUKAGJINI'	5-4
'LAJMI.NET' - 'EPOKA E RE'	3-11
'EPOKA E RE' - 'RTK'	5-2
'KALLXO.COM' - 'EPOKA E RE'	0-7
'EPOKA E RE' - 'KLAN KOSOVA'	5-2
'KOSOVAPRESS' - 'EPOKA E RE'	0-3
'EPOKA E RE' - 'GAZETA METRO'	5-3
'D+' - 'EPOKA E RE'	6-3
'EPOKA E RE' - 'TELEGRAFI'	3-0

për 'Epokën e re' në përballjen e dytë me 'Ora Info'-n, pasi barazuan 4-4. Në ndeshjet e tjera 'Epoka...' doli fituese dhe dy xhiro pa përfunduar kampionati e siguroi titullin, pas fitores ndaj 'Gazetës Metro', kurse në ndeshjen e parafundit 'Epoka e re' me disa ndryshime në formacion u befasua nga 'D+', e cila e mposhti me rezultat 6-3. Sponsor i fanellave të 'Epokës së re' ishte kompania 'Selman's', ndërsa sponsorë të kësaj lige ishin 'Ujë Rugove' dhe 'Givova', kurse ndeshjet janë zhvilluar në fushën 'Arena 2' dhe janë drejtuar nga gjyqtarët Granit Hyseni dhe Alban Shala. Në vendin e dytë ka përfunduar 'Infokusi', kurse në vendin e tretë 'Media Works'.



Gjilani largon 10 futbollistë

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Pas përfundimit të edicionit 2018/2019, skuadra e Gjilanit ka vendosur ta ndërpresë bashkëpunimin me 10 futbollistë të cilët bartën fanellën e klubit tonë në edicionet e fundit. Një nga emrat më të mëdhenj që largohet nga kjo skuadër është

Fisnik Papuqi, i cili për dy edicione ishte pjesë e skuadrës së Gjilanit. Klubi nga Anamorava e ka falënderuar mbrojtësin pejan për kontributin dhe korrektësinë e treguar gjatë kësaj periudhe kohore. 'Sport Club Gjilani ka mbyllur marrëveshjet edhe me futbollistët të

cilët ishin transferuar vitin e kaluar në ekipin tonë: Jefferson Lopes, Wilber Perez, Ansi Nika, Endrien Magani, Vilson Lila, Kledi Koci, Vilfor Hysa, Shpend Asani dhe Semir Hadzibuliq. Klubi i falënderon futbollistët e lartcekur për kontributin e tyre gjatë këtij udhë-

timi të edicionit që e lamë pas dhe u uron suksese në vazhdimin e karrierës së tyre, thuhet në njoftimin e Gjilanit. Në këtë njoftim, Gjilani ka konfirmuar se është në bisedime me futbollistët e tjerë dhe me disa lojtarë si përforcime për edicionin e ri futbollistik.



Llapi vazhdon kontratën me Prençin, transferon edhe Arrabalin

PODUJEVË, 7 QERSHOR - Skuadra e Llapit në kuadër të përgatitjeve për edicionin e ri 2019/2020 ka arritur marrëveshje për rinovimin e kontratës me qendërmbrojtësin nga Shqipëria, Elvis

Prençi. 'Kontratën edhe për një vit me Llapin e ka vazhduar qendërmbrojtësi i ardhur në janar, Elvis Prençi, i cili ka pasur paraqitje shumë të mira në edicionin pranveror. Edhe pse në

drejtim të tij kishte shumë oferta, Elvsi zgjodhi Llapin dhe është i gatshëm të vazhdojë t'i jap stabilitetin mbrojtjes edhe për edicionin e ri', thuhet në njoftimin e Llapit. Skuadra nga

Podujeva ka arritur ta transferojë edhe njërin nga mesfushorët defansiv më të mirë në Shqipëri, brazilianin Bruno Arrabal, i cili në sezonin e fundit ishte pjesë e Kamzës.



Sot Islandë - Shqipëri, debuton Reja



TIRANË, 7 QERSHOR - Trajneri italian Edy Reja e ka zëvendësuar në rolin e trajnerit në Kombëtaren e Shqipërisë, Christian Panuccin. Reja sot (e shtunë) debuton në stolin kuqezi në ndeshjen ndaj Islandës, e cila zhvillohet nga ora 15:00 në 'Laugardalsvöllur'. 'Të gjithë grupin e njoh mirë. Ka një organizim të mirë në të gjithë fushën. Ka Sigurdssonin që është një lojtar shumë i mirë dhe kyç si në teknikë dhe në fizik. Ne do të shkojmë në fushë për ta bërë lojën tonë. Nëse do ta presim lojën e tyre do të bëhen shumë të rrezikshëm', ka thënë Reja, i cili më pas ka treguar edhe avantazhet e kundërshtarit ndaj kuqezinjve. 'Krosimet dhe godit-

jet standarde do të krijojnë shumë probleme për ekipin dhe unë i kam marrë masat', ka shtuar ai.

Trajneri Reja ka refuzuar ta zbulojë formacionin për ndeshjen ndaj Islandës, por nuk e ka përjashtuar mundësinë që të luajë me dy sulmues. 'Këtë nuk e dinë lojtarët, nuk ua kam thënë atyre, kështu që duhet të pritët e shtuna. Mirë është të dinë ata të parën dhe pastaj ju. Me dy sulmues është një projekt, por të shtunën do të duket çdo gjë', ka deklaruar Reja. Shqipëria në kuadër të kualifikueseve ka zhvilluar dy ndeshje, ku fillimisht është mposhtur nga Turqia si vendëse dhe ka shënuar fitore si mysafire e Andorrës.

GRUPI C
18:00 Estonia - Irlanda e Veriut
20:45 Bjellorusia - Gjermania

GRUPI E
15:00 Kroacia - Uells
18:00 Azerbejxhani - Hungaria

GRUPI H
15:00 Islanda - Shqipëria
18:00 Moldavia - Andorra
20:45 Turqia - Franca

GRUPI I
18:00 Rusia - San Marino
20:45 Belgjika - Kazakistan
20:45 Skotlanda - Qipro

GRUPI J
18:00 Armenia - Letenshtajni
18:00 Finlanda - Bosnja H.
20:45 Greqia - Italia

Hamiltoni: Formula 1 duhet të jetë sporti më i lodhshëm në botë

LONDËR, 7 QERSHOR - Piloti britanik Lewis Hamilton, nga Montreali, ku ditën e diel do të zhvillohet gara e Çmimit të Madh të Kanadasë në Formula 1, ka folur për këtë sport. Pesë herë kampioni i botës, ashtu si shumë fansa, është i shqetësuar për faktin se ky sport ka humbur bukurinë dhe spektaklin. Sipas Hamiltonit, përpjekjet që bëhen janë të pakta dhe në drejtim të gabuar. 'Në 12 vjetët e fundit apo edhe më shumë, ndryshimet në rregullore kanë qenë më së shumti në uljen e kostove sesa në drejtim të spektaklit. Kjo do të thotë se ndryshimet jo gjithnjë kanë qenë pozitive dhe problemet kanë vijuar. Dallimi mes makinave kryesore dhe atyre të vogla është shumë e madhe, ndaj këto ndryshime në rregullore nuk mjaftojnë', ka thënë Hamiltoni. 'Problemi madhor është



që fundjavat janë të njëjta, formati nuk ndryshon. Këtu duhet punuar më shumë. Unë do të rikthehesha te motorët v12 me kambio manuale, do t'i largoja hapësirat e mëdha të tërheqjes së makinave në pistë si dhe disa ndryshime mekanike. Garat duhet të jenë si një maratonë për ne pilotët,

që të sflitemi. Nëse vazhdon kështu mund të bëj 2-3 gara radhazi. Ky është një sport për të rritur, ndërsa sot shumë të rinj adaptohen menjëherë, pasi gjithçka është kompjuterike. Ky duhet të jetë sporti më i lodhshëm në botë', ka deklaruar Hamiltoni.

SHKURT

Aguero: E dua Kupën e Amerikës për Messin

Ylli i Manchester Cityt, Sergio Aguero, e pranon se ai dëshiron ta fitojë titullin e Kupës së Amerikës më shumë për Lionel Messin sesa për veten. 'Jam më në ankth të bëhem kampion për Messin sesa për veten. Shpresoj që ndonjë ditë do të ndodhë. Është ëndrra e tij dhe e të gjithë të tjerëve. Unë e vendos veten në vendin e tij dhe dua ta bëj më të mirën time për ta fituar trofeun e Kupës së Amerikës', ka thënë Aguero. 'Është bërë një kohë e gjatë që ai vjen këtu dhe vuan. Edhe unë vuaj gjithashtu. Ne e dimë çfarë mund të sjellë ai dhe të gjithë të tjerët duhet të jemi të përgatitur për të mos dështuar', ka deklaruar Aguero.

Buffoni mund t'i bashkohet Barçës

Gianluigi Buffon është në kërkim të një tjetër aventure në futbollin e luajtur, pas divorcit me PSG-në. 41-vjeçari ka vendosur të mos heqë dorë teksa është duke shqyrtuar mundësitë e transferimit. Mediet italiane kanë dhënë një lajm të bujshëm që e lidhni gardianin me Barcelonën. Sipas gazetarëve sportivë, Tancredi Palmeri dhe Gianluca Di Marzio, blaugranasit janë duke menduar për ta afruar fituesin e Kupës së Botës në 'Camp Nou', si portier të dytë pas Ter Stegen. Buffoni kërkon të fitojë me çdo kusht trofeun e Ligës së Kampionëve, teksa transferimi te Barcelona do të ishte një mundësi e artë, për ta bërë këtë ëndërr realitet. Në ditët e ardhshme pritët që gardiani 41-vjeçar ta marrë vendimin në lidhje me të ardhmen e tij.

Juve ofron Higuainin për Zaniolon

Kampioni i Italisë, Juventus, është duke planifikuar transferimin e yllit të Romës, Nicolò Zaniolo. 'Zonja e Vjetër' ka gati 50 milionë euro për këtë futbollist, por është duke prituar largimin e Edin Dzekos për të ofruar si shkëmbim Gonzalo Higuainin. Sulmuesi argjentinas në edicionin e fundit ishte i huazuar në Milan dhe Chelsea, kurse nuk bën pjesë në planet e Joves as për sezonin e ri.

De Rossi, afër Boca Juniorsit

Daniele De Rossi është larguar nga Roma dhe vazhdon të jetë lojtar i lirë. Interesimi për shërbimet e tij është i madh nga shumë skuadra, por mediet italiane raportojnë se De Rossi është afër marrëveshjes me Boca Juniorsin, skuadër tek e cila pritët të luajë për gjashtë muaj, para se të transferohet në Amerikë, më saktësisht tek ekipi i Los Angeles Galaxy, ku luan edhe Zlatan Ibrahimović.

Nadali, shumë i fortë për Federerit

'Dueli i superheronjve'. Këto fjalë kishte zgjedhur spanjollja 'AS' për ta përshkruar gjysmëfinalen e 'Roland Garros' midis Rafael Nadalit dhe Roger Federerit. Një ndeshje e bukur u zhvillua, por në fund triumfoi spanjollja i cili është fantastik në fushat me dhe. Nadal i fitoi të tre setet me rezultatet 6-3, 6-4, 6-2 dhe tani do të përballët në finalen e madhe kundër Novak Xhokovićit ose austriakut Dominik Thiem (për momentin kryeson 1-0 me sete). 11 herë ka arritur të fitojë spanjollja Roland Garros, ndërsa 37-vjeçari zviceran, i cili u largua mes duartrokitjeve të publikut, nuk merre pjesë që nga viti 2015 në turneun francez. Me këtë fitore Nadali e përmirësoi rekordin e tij kundër Federerit, me 24 fitore dhe 15 humbje. Nesër në orën 15:00 zhvillohet finalja e madhe dhe Nadali do ta kërkojë triumfin e 12 në kompeticionin e tij të preferuar.



EPOKA E RE		Autor: GAZMEND MORINA	VËLLIMI, MASA	VËMENDJE E KUJDES I VEÇANTË QË TREGOJMË PËR DIÇKA (shq.)	AI QË DEHET ME ETER	SHKRIMTARJA KAMBERI	MIRË DE, NË RREGULL	SHTET NË AFRIKË	ZANORE	LLOJ PJEPI I VERDHË, I QULLËT E ME SHUMË LËNG, POR JO I SHIJSHËM	PËRHAPJA E VALËVE	BASHKËT.	EPOKA E RE
		AKTORJA ANGLEZE NË FOTO											JAM I DENJË TË NDEROHËM E VLEJ TË MË JEPET NJË ÇMIM
		MJET PËR PËRÇIMIN E VALËVE (shq.)							ALYSSA MILANO			BASHKËT. ORGANI I RIPRODHIMIT TË BIMEVE	
		SHTERPË QYTET NË SHQIPËRI							KAFSHË SHTEPIAKE PËRTYPËSE TENISTI SAFIN				
							AXHAMI, KALAMA AGIM TEJECI						
		ERA E KËNDSHME						KOMPOZITORI KOCI (shq.) PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE					
		LETRARI ZYKO KAMBERI	QË I PESHON MIRË VEPRIMET A FJALËT; E KUJDESSHME DILETANTET							AKTORI HOLLIVUDIAN ... DAMON (shqip.) KËPUÇË PËR RRËSHQITJE MBI AKULL			
							DOKUMENT I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS HISTORIANJA KËÇMEZI BASHA					OHIO ISH PRESIDENTI AMERIKAN HARRY	
EPOKA E RE	QË BËHET NDERMJET TRI PALËVE	BARAZIM NË SHAH	PUNËTOR QË PASTRONTE E RREGULLONTE DHOMAT NË HANE (vjet.)	3.14 (mat.)	ZANORE	SHTET FEDERAL NË SHBA LETRARI XOXA						DY BASHKË-TINGËLLORE KAMPIONI	
	QYTET NË SHQIPËRI						ISLANDA KËNGËTARJA KANADEZE MORISSETTE	ANTON PASHKU KUNDREJT E VJETËR		RAST FILMI I PARË SHQIP			MUZIKOLOGU SHQIPTAR SOKOLI
	ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR JUPI				PËREMËR VETOR DY BASHKË-TINGËLLORE		E MBARUAR, E PËRFUNDUAR ZANORE						
	KËNGËTARJA ANGLEZE BUNTON		TRAJNERI BRAZILIAN LUIZ FELIPE SHKRITËTIRA MË E THATË NË BOTË						SHPIRTI (Lat.) SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE				
	FILOZOF NË GREQINË E LASHTË					PRINCESHA RUMUNE GJIKA EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN					ARIAN MALIQI SHTET NË AZI		
	QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE				DAMARI I GJAKUT REKUZITË SPORTIVE (shq.)			FRYMA KOHË BRENDA SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË PUNË		KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA DY BASHKË-TINGËLLORE			
	VEGËL MUZIKORE E PËRDORUR QË NË KOHË TË LASHTA (sh.shq.)					KËNGËTARJA TARNËR SHINË E TRENIT			ZANORE ERNEST KOLIQI	ROBERT REDFORD		BASHKËT. SHENJA MUZIKORE	
	SHKRONJA VIII & XVIII		HATA FARISHTË			DËSHMORI PEÇI VIJË A RREMB UJI QË KALON NËN TOKË				SHTET NË AFRIKË TËPSI PREJ BALTE (sh.shq.)			
	BASHKËT.	I VRULLSHËM SHAPKA				MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI (pashq.)					TRUP GJEOMETRIK MJET SI KAMBANË FARE E VOGËL (sh.shq.)		
EPOKA E RE	FURRË KU PIQEN TULLA (sh.shq.) ATDHE						BASHKËT. KAJDE, OJNA (sh.shq.)	LËNG QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTËS DHELPËRI (sh.shq.)					ISH FUTBOLLISTI YNË SHAQIRI
	PATRIOTI PASHKO				"ASHTU QOFTË" TOKË E BUKËS (sh.shq.)			FUTBOLLISTI SPANJOL MARTINEZ (shqip.)				SHKRONJA TË NJËJTA POETI RAÇI	
	VËLLAI I MADH		LLOJ KARROCE KUJAJSH NJËSI KOHE					ZANORE GAZETARJA SHIPTARE ... TIÇO		EMRI I PASHAIT TË JANINËS		SHKRONJA XXIV SHOUMENI KRASTA	
	MUAJ I VITIT				NJERI I PACIPË E I PAFYTYRË, NJERI I POSHTËR MARK ANTONI					OBJEKTI I BISEDËS (sh.shq.) NJË NGJYRË			
	ATALANTA, LIVORNO		KORNIZË BASHKËT.			FUTBOLLISTI ARGJENTINAS KARLOS BASHKËT.				ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHERINGAM BASHKËT.			
	ANIJATË; PJESE E BRENDSHME E NJË KISHE (sh.shq.)						FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE					VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteti Bolniçka i Kliniçka Služba Kosova - Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"
Prizren



03/L-212 sayılı Çalışma Kanununun 8. maddesine dayanarak, HKÜH'nun konkur işlemlerini düzenleyecek 07/2017 sayılı İdari Yönerge'nin, 10. maddesine, 04/L-125 Sağlık Kanunu'nun 62 maddesinin 6 fıkrası uyarınca, 2/102 numaralı 22.05.2019 tarihinde işe alım talebi ve 23.04.2019 tarihinde HKÜH'nun Yönetim Kurulunun tarafından onaylanan, ve 2/69 numaralı 19.04.2019 tarihinde işe alım talebi ve 19.04.2019 tarihinde ZKF ve HKÜH tarafından onaylanan, aynı zamanda Hastane statüsününün 13. maddesi 1.1 fıkrasına göre Genel Hastane Yönetim Kurulu şunu ilan eder

KAMUSAL İŞ İLANI

İşçi alınımı için:

Görev ünvanı:

1. Uzman doktor – patoloj: 1 konum

Maaş katsayısı: 8.4

Çalışma standardı: Tam iş süresi

Sözleşmenin süresi: Süresiz deneme süresi ile 3 (üç) ay

2. Uzman doktor – Fiziyatrist: 1 konum

Maaş katsayısı: 8.4

Çalışma standardı: Tam iş süresi

Sözleşmenin süresi: Süresiz deneme süresi ile 3 (üç) ay

3. Mezun eczacı – üniversite: 1 konum

Maaş katsayısı: 7.2

Çalışma standardı: Tam iş süresi

Sözleşmenin süresi: Süresiz deneme süresi ile 3 (üç) ay

4. Eczacı teknisyeni – orta okul: 2 konum

Maaş katsayısı: 4.8

Çalışma standardı: Tam iş süresi

Sözleşmenin süresi: Süresiz deneme süresi ile 3 (üç) ay

5. Laboratuvar teknisyeni - orta okul, tıbbi yön: 1 konum

Maaş katsayısı: 5.4

Çalışma standardı: Tam iş süresi

Sözleşmenin süresi: Süresiz deneme süresi ile 3 (üç) ay

Referans sayısı: 8/26, tarih: 07.06.2019

İş yerinin ana hedefi: Tüm pozisyonlar için: İkincil sağlık hizmetlerinin sağlanması.

Temel görevler: Klinik, yönetsel ve profesyonel

Temel sorumluluklar: Sağlık hizmetlerinin, profesyonel nezaket seviyesine dayanan niteliksel ve niceliksel bir şekilde sunulması, hasta ve çalışan personele özen ve saygı gösterilmesi.

İşe alım katılım için gerekli şartlar: Uygun-yeterli eğitim almış ve başvurdukları iş ilanına hak kazanmış tüm Kosova Cumhuriyeti vatandaşları başvuru hakkına sahiptir.

1. ve 2. konum için gerekli nitelikler : Uzman doktor – patoloj ve fiziyatrist: İlgili alanda yapılan uzmanlık

Gerekli belgeler:

1. Tıp fakültesi diploması – (orjinal veya onaylı kopya)

2. Uzmanlık Belgesi - (orjinal veya onaylı kopya)

3. Sağlık Bakanlığı tarafından verilen çalışma izni geçerlidir (orjinal veya onaylı kopya)

4. Doğum belgesi (orjinal veya onaylı kopya) ve kimlik kartı fotokopisi

5. Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge (orjinal veya onaylı kopya)

6. Sağlık raporu (işe alındıktan sonra)

Mezun eczacı – üniversite için gerekli nitelikler:

Gerekli belgeler:

1. Tıp fakültesi diploması – (orjinal veya onaylı kopya)

2. Uzmanlık Belgesi - (orjinal veya onaylı kopya)

3. Doğum belgesi (orjinal veya onaylı kopya) ve kimlik kartı fotokopisi

4. Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge (orjinal veya onaylı kopya)

5. Sağlık raporu (işe alındıktan sonra)

